



Canada

BAROMETRI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI

2024

BAROMETRI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI

2024

Qershor 2024

Metodologjia dhe analiza e të dhënave të sondazhit:

Znj. Mikela Gjapi, Konsulente

Znj. Eralda Gjika, Eksperte Statisticiene

Monitorimi i Institucioneve:

Ardit Minarolli, Dallandyshe Xhaferri, Edlira Bylo, Enegrida Bënja, Erdion Maçolli, Eriselda Ndreca, Ernest Delia, Luljeta Alibali, Maend Kullaj, Nikolin Muçaj, Nosiana Burnazi, Preng Gjokolaj

Mbledhja e të dhënave nëpërmjet pyetësorëve:

Altea Hoxhaj, Bukurosh Onuzi, Eriona Pambuku, Joana Çepuni, Jon Kola, Marlivja Mellaraj, Matea Rexhepi, Paula Kapllanaj, Vitori Çipi

Rishikoi:

Znj. Anda Kruetani, Koordinatorë Projektesh, KShH

Znj. Ardita Matlija, Asistente Projektesh, KShH

Kontroll cilësor:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH

Publikuar nga:

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit (Maj, 2024). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10,

Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752;

Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;

E-mail:office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

Ky raport u hartua në kuadër të projektit “*Monitorimi i të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet fuqizimit të mbrojtësve lokalë të të drejtave të njeriut (HRD) përmes sesioneve të punës, misioneve të përbashkëta të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave fillestare*” mbështetur financiarisht nga Qeveria Kanadeze.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e qeverisë së Kanadasë.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
METODOLOGJIA	9
I. E DREJTA PËR NJË STANDART JETË DINJITOZE	12
STREHIMI SOCIAL DHE MENAXHIMI I BANESAVE SOCIALE, BASHKIA KORCË	22
II. E DREJTA E PUNËS	24
MONITORIMI I RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË PUNONJËSVE TË FASONERIVE, CALL CENTER, MINIERAVE DHE MEDIAS	33
AKSESI NË PUNËSIM NË QYTETIN E KUKËSIT	37
III. E DREJTA E PRONËS	39
TRANSPARENCA NDAJ QYTETARËVE DHE PJESEMMARRJA E TYRE NË PROCESË VENDIMMARRËSE TË LIDHUR ME TË DREJTAT PRONËSORE DHE TË MJEDISIT	47
i. <i>Mbi shembjen e pallatit pranë rrugës “Myslym Keta”, në kuadër të procesit të ri-ndërtimit</i>	47
ii. <i>Mungesa e informimit dhe përfshirjes së banorëve në çështjet mjedisore (ndërtimi i digës së kavicës mbi lumi “Drin i Zi”)</i>	48
IMPAKTI I NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE TE QYTETARËT E BASHKISË GRAMSH	49
NDIKIMI I AKSIT RRUGOR THUMANË-KASHAR NË TË DREJTAT PRONËSORE TË BANORËVE TË BASHKISË BËRXULL	50
IV. PJESEMMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE KONSULTIMI PUBLIK	51
<i>Informacion i përgjithshëm për të anketuarit</i>	51
LIRIA E TUBIMEVE	58
PJESEMMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE USHTRIMI I DREJTËPËRDREJTË I SOVRANITETIT TË POPULLIT	60
V. AKSESI NË DREJTËSI	63
AKSESI NË DREJTËSI I GRUPEVE NË NEVOJË	69
VI. BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI	72
VII. E DREJTA PËR UJË TË PASTËR E TË PIJSHËM	82
VIII. E DREJTA PËR AKSES NË EDUKIM DHE ARSIM CILËSOR	88
<i>Informacion i përgjithshëm për të anketuarit</i>	88
2. <i>Gjetjet Kryesore: E drejta për akses në edukim dhe arsim cilësor</i>	89
MONITORIMI I AKSESIT NË EDUKIM – NXËNËSIT E FSHATIT “BROJË”	93
IX. E DREJTA PËR JETË TË SIGURT DHE KUFIZIMI I LIGJSHËM I LIRISË	94

I. HYRJE

Misioni i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) është të kontribuojë në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën tonë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

Në përputhje me misionin e tij dhe në kuadër të nismës ‘Monitorimi i të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet fuqizimit të mbrojtësve lokalë të të drejtave të njeriut (HRD) përmes sesioneve të punës, misioneve të përbashkëta të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave fillestare’ financuar nga Qeveria Kanadeze, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) ndërtoi dhe zbatoi “Barometrin për të drejtat e njeriut në Shqipëri 2023” për matjen e respektimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë përgjatë vitit 2023.

Viti 2023 shënoi sfida dhe zhvillime kritike për situatën e respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat janë reflektuar në këtë raport. Raporti ka qëllim të informojë publikun, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në vendin tonë, mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, si dhe të rrisë llogaridhënien e autoriteteve publike për përmirësimin e veprimtarisë së tyre për një mbrojtje dhe respektim më të mirë të të drejtave themelore të njeriut.

Barometri synoi të analizojë në mënyrë objektive si dhe të masë nivelin e respektimit të 9 të drejtave, përfshirë: e drejta për një standart jete dinjitoz; e drejta e punës; e drejta e pronës; e drejta për jetë të sigurt dhe kufizimi i ligjshëm i lirisë; e drejta për pjesëmarrje në jetë publike dhe konsultimi publik; e drejta e aksesit në drejtësi; e drejta e barazisë dhe mosdiskriminimit; e drejta për ujë të pastër e të pijshëm; dhe e drejta për akses në edukim dhe arsim cilësor. Të dhënat cilësore dhe sasiore të Barometrit lidhur me këto të drejta janë mbledhur dhe përpunuar me anë të kryqëzimit të informacionit të siguruar nga anketimi i qytetarëve në 12 qarqe të vendit, të dhënat zyrtare nga institucionet shtetërore dhe hulumtimin online apo nëpërmjet të dhënave të evidentuara nga raporte dhe studime të tjera të KShH-së.

Së fundmi, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të thellë për të gjithë ata që kanë mbështetur dhe kontribuar në realizimin e këtij raporti. KShH falenderon të gjithë mbrojtësit e të drejtave të njeriut të angazhuar në këtë nismë, Ardit Minarolli, Dallandyshe Xhaferri, Edlira Bylo, Enegrida Bënja, Erdion Maçolli, Eriselda Ndreca, Ernest Delia, Luljeta Alibali, Maend Kullaj, Nikolin Muçaj, Nosiana Burnazi dhe Preng Gjikota për proaktivizmin, profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre. Falenderojmë në mënyrë të veçantë stafin e KShH-së që kontribuan në zbatimin e kësaj nisme të rëndësishme, si dhe Qeverinë Kanadeze për mbështetjen dhe bashkëpunimin për realizimin e Barometrit për të drejtat e njeriut në Shqipëri për vitin 2023.

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

E DREJTA PËR NJË STANDART JETE DINJITIZ

Për 33% të të anketuarve, të ardhurat mujore janë nën rrogën minimale, pra më pak se 30,000 në muaj ose nuk kanë asnjë të ardhur. 15% të të anketuarve pohojnë se shpenzojnë deri në 25% të të ardhurave të tyre mujore drejt sigurimit të një strehimi të përshtatshëm. 41% e të anketuarve pohojnë se programi i strehimit nuk zbatohet në mënyrë të barabartë dhe vetëm 1 në 5 persona (20%) pohuan se zbatimi i programit të strehimit social garanton barazi për të gjithë. Pothuajse 1 në 5 persona (18%) shprehen se strehimi i tyre nuk është i përshtatshëm për një jetëse të qetë dhe dinjitoze ndërkohë që shqetësues është fakti se 1 në 3 persona pohojnë se banesa e tyre nuk ka lehtësi apo hapësira për personat me aftësi të kufizuara. Gjatë një monitorimi në banesat sociale në bashkinë Korçë, u evidentuan problematika me kushtet jo të mira me lagështirë të theksuar dhe myk.

Në Shqipëri, punësimi vijon të mbetet problematik. Rezulton se 15.5 % e të anketuarve janë të papunë, si dhe 10.8% studentë. Pjesa më e madhe e të anketuarve (73%) nuk kanë aplikuar për të përfituar nga shërbimet e punësimit kundrejt 27% të tyre të cilët pohuan se kanë aplikuar.

82% e të anketuarve kanë dijeni rreth kujdesit shëndetësor apo social kundrejt 18% që nuk kanë dijeni për këto shërbime. Shumica e të anketuarve (49%) referojnë se mbështetja e tyre me asistencën sociale është aspak e mjaftueshme, në raport me nevojat që kanë.

E DREJTA E PUNËS

Shumica e të anketuarve (59%) pohojnë se nuk u është kërkuar të punojnë pa një kontratë me punëdhënësin, ndjekur nga 41% të cilëve u është kërkuar diçka e tillë. 62% e të anketuarve pohojnë se kanë një kontratë pune me shkrim kundrejt 22% të cilët nuk kanë një kontratë.

56% e të anketuarve pohuan se paguhen vetëm nëpërmjet bankës. Për 24% e tyre, pagesa bëhet në kushte të plota ose të pjesshme informaliteti (13% e të anketuarve pohojnë se paguhen me para në dorë ndërsa 11% pohojnë se paguhen pjesërisht me bankë dhe pjesërisht me para në dorë).

14% e të anketuarve pohuan se ndihen të rrezikuar për shëndetin dhe sigurinë e tyre për shkak të punës që bëjnë. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 35% e tyre nuk kanë informacion për organizimin në sindikata ndërsa 49% pohojnë se sindikatat nuk japin rezultatin e dëshiruar.

KShH monitoroi respektimin e të drejtave të punëtorëve, me fokus sektorë të fasonerive, *call centers*, minierave dhe medias. Problematikat kryesore me të cilat përballen punonjësit e këtyre

sektorëve janë të ngjashme si në vijim: siguria në punë, mungesa e mjekëve në punë, shkelja e të drejtave të punonjësve në drejtim të pushimeve vjetore, sigurimeve shoqërore, procedurat dhe afatet e ndërprerjes së kontratave, mungesa e njohjes së vjetërsisë në punë si dhe mungesa e një bashkëpunimi efektiv mes sindikatave të punonjësve dhe Inspektoratit të Punës, etj.

E DREJTA E PRONËS

56% e të anketuarve pohuan se janë shpronësuar ose u është marrë në përdorim prona private nga shteti. Po 56% e tyre pohuan se kanë bërë kërkesa për kthimin apo kompensimin e pronës së shtetëzuar kundrejt 44% që pohuan të kundërtën. 60.5% e të anketuarve pohuan se nuk e kanë ushtruar të drejtën e ankimit në rastet e shpronësimit, kthimit apo kompensimit të pronës, kundrejt 39.5% të cilët pohuan se e kanë ushtruar këtë të drejtë. 52% e të anketuarve pohuan se shpërblimi për shpronësimin e pronës nuk ka qënë i drejtë ndjekur nga vetëm 15% të cilët shprehen të kënaqur me shpërblimin. Pavarësisht se pjesa më e madhe e të anketuarve kanë shfaqur pakënaqësi lidhur me masën e shpërblimit të shpronësimit të tyre, pjesa dërmuese e tyre ka pohuar se nuk janë ankuar për masën e shpërblimit (59%).

Shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e të anketuarve (37%) shprehen se ky proces ka zgjatur mbi 30 vite ndjekur nga 22.44% të cilët pohojnë se proceset kanë zgjatur 11-20 apo 21-30 vite. Si rrjedhojë e kohëzgjatjes me natyrë zvarritëse, shumica e të anketuarve ose 55% e tyre kanë pohuar se nuk kanë ndjekur rrugën gjyqësore në rastet kur nuk kanë qënë dakord me vendimet lidhur me pronën e tyre, kundrejt 45% të të anketuarve të cilët kanë pohuar të kundërtën.

Ndër arsytet për vonesat dhe padrejtësitë në procesin gjyqësor përfshihen: korrupsioni, mungesa e profesionalizmit, ndryshimi i shpeshtë i ligjeve, ngarkesa në gjykata, mungesa e dëshirës nga institucionet përgjegjëse, mosrespektimi i vendimeve të GjEDNJ-së, ndikimi politik etj.

PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE KONSULTIMI PUBLIK

86% e të anketuarve pohojnë se kanë marrë pjesë gjatë votimeve në zgjedhjet e vitit 2023. 80% prej tyre pohuan se kanë patur informacion paraprak për qëndren ku ishin votues. Më shumë se 1 në 5 persona (22.7%) pohon se u është ushtruar presion për të votuar në zgjedhje kundër vullnetit të tyre ndërsa shumica (77.3%) pohon të kundërtën.

KShH vlerëson se një matës i rëndësishëm i angazhimit të qytetarëve në jetën publike është angazhimi në proceset vendimmarrëse të Këshillit Bashkiak pranë vendbanimit të tyre. 73% e të anketuarve pohuan se nuk janë konsultuar ndonjëherë për çështje që diskutohen në mbledhjen e këshillit bashkiak kundrejt 27% të cilët pohuan se janë konsultuar. 66% e të anketuarve pohuan se

nuk kanë informacion rreth konsultimit publik të projektbuxhetit të bashkisë ku banojnë kundrejt 34% që pohuan se janë të informuar mbi konsultimin e projektbuxhetit. Është shqetësues fakti se 40% e të anketuarve pohuan se ky proces nuk realizohet me qëllim për të marrë mendimet e të qytetarëve ndjekur nga 26.5% të cilët nuk kanë dijeni nëse konsultimi ka këtë qëllim ose jo. Vetëm 17,5% e të anketuarve pohojnë se konsultimi është i vërtetë.

AKSESI NË DREJTËSI

Shumica e të intervistuarëve pohojnë se janë të informuar mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti (37.7%) ose pjesërisht të informuar (21.7%), ndërsa 40.6% e të anketuarve mohojnë të kenë dijeni. Këto të dhëna janë tregues i nevojës për rritur ndërgjegjësimin për të siguruar akses më të mirë të qytetarëve në ndihmën ligjore të ofruar nga shteti në rast pamundësie financiare.

14% e të anketuarve kanë përfituar ndihmë ligjore falas. Për 57% të këtyre rasteve, kjo ndihmë nuk ka qënë profesionale dhe efektive, kundrejt vetëm 24% të rasteve që vlerësohet me nota pozitive, dhe në 19% të rasteve pjesërisht pozitive (profesionale e efektive).

32% e të anketuarve pohuan se gjykata në qytetin e tyre është shkrirë, kundrejt 38% të cilët mohuan një gjë të tillë. Për pjesën më të madhe të të anketuarve (39.4%), largësia do t'i pengonte plotësisht ose pjesërisht në hapjen e një procesi gjyqësor, ndjekur nga 36% që e mohojnë këtë pengesë.

Për pjesën më të madhe të personave që kanë lexuar një vendim gjyqësor, rezulton se vendimet janë pjesërisht (38%) ose aspak të qarta dhe të thjeshta (39%) për t'u kuptuar pa ndihmën e një juristi. Vetëm 23% e të anketuarve pohuan se vendimet që kanë lexuar kanë qënë të kuptueshme.

Akresi në institucionet e drejtësisë për personat me aftësi të kufizuar është i limituar, pasi infrastruktura e përshtatshme (parkimi i veçantë, rampa dhe ashensori, tualetet dhe shkrimet *braille*) ofrohen vetëm në godinat e institucioneve të ndërtuara së fundmi.

BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI

Rreth 1 në 4 persona kanë përjetuar bullizëm në vendin e punës, kundrejt shumicës së të anketuarve, 80.5%, të cilët mohojnë të kenë përjetuar bullizmin. Ndër rastet më të zakonshme janë përdorimi i etiketimeve raciste, etiketimeve për shkak të origjinës, etiketimeve gjinore (drejtuar vajzave dhe grave).

11% e të anketuarve kanë pohuar se janë ngacmuar seksualisht në punë, ndërkohë që 89% e tyre mohojnë situata të tilla. Shqetësues është fakti se vetëm një pjesë shumë e vogël e të anketuarve që kanë pohuar se kanë qenë viktimë e abuzimit seksual në vendin e punës kanë pohuar se i kanë raportuar ato (7% e tyre), kundrejt 93% të të anketuarve të cilët nuk kanë raportuar.

E DREJTA PËR EDUKIM

Shumica e të anketuarve (59%) janë prindër të një fëmije që është duke ndjekur shkollën në sistemin parauniversitar. 33% e të anketuarve pohuan se të ardhurat mujore i lejojnë ata që të përmbushin nevojat e fëmijëve të tyre për arsim, ndjekur nga 24% të cilët pohojnë se i përmbushin këto nevoja pjesërisht. Ndërkohë, 21% e të anketuarve pohojnë se nuk mund t'i përmbushin nevojat e fëmijëve të tyre lidhur me arsimimin për shkak të të ardhurave të tyre mujore familjare.

Shumica e të anketuarve (53.8%) kanë dijeni sa i takon bursave të shkollimit, kundrejt 46.2% të të anketuarve të cilët shprehen se nuk kanë dijeni rreth bursave për kategoritë në nevojë. Në shumicën e rasteve, regjistrimi në shkollë nuk përbën problem apo vështirësi për të anketuarit (60%). Për 19% të tyre, regjistrimi i fëmijës në shkollën më të afërt me vendbanimin rezulton se ka qenë i vështirë (10%) ose pjesërisht i vështirë (9%) .

Rreth gjysma e të anketuarve (ose 47%) pohojnë se kanë komunikim të rregullt me stafin e shkollës në lidhje me shkollimin e fëmijës së tyre, ndjekur nga 17% e tyre, për të cilët komunikimi është i pjesshëm dhe 12% e të anketuarve që pohuan se nuk e kanë këtë komunikim të rregullt.

51% e të anketuarve mendojnë se mundësitë për fëmijët për të ndjekur shkollën janë të barabarta, ndjekur nga 20% e të anketuarve të cilët mendojnë se mundësi të tilla janë pjesërisht të barabarta, ndërkohë që 13% e tyre mendojnë se këto mundësi nuk janë të barabarta.

E DREJTA PËR JETË TË SIGURT DHE KUFIZIMI I LIGJSHËM I LIRISË

KShH monitoroi Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë Krujë me qëllim verifikimin e kushteve të jetesës së qytetarëve që vuajnë dënimin pranë këtij institucioni. Disa nga problematikat e evidentuara gjatë monitorimit janë: mbipopullimi; vakancat në stafin administrativ, stafin me uniforme dhe stafin mjekësor; amortizimi i infrastrukturës së godinave; mungesa e botimeve të përditësuara në bibliotekë; mungesa e ujit të ngrohtë dhe ujit të pijshëm.

III. METODOLOGJIA

Metodologjia e ndërtimit të pyetësorit dhe raportit

Në kuadër të nismës së mbështetur financiarisht nga Qeveria Kanadeze¹ është realizuar Barometri Kombëtar për matjen e respektimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë përgjatë vitit 2023, i cili synon të analizojë në mënyrë objektive si dhe të masë nivelin e respektimit të 9 të drejtave:

1. E drejta për një standart jete dinjitoz (p.sh. kushtet e strehimit, standardet minimale të jetesës, etj.);
2. E drejta e punës (duke u përqëndruar tek respektimi i kushteve të punës në sektorë si: fasoneritë, *call centers*, minierat dhe mediat);
3. E drejta e pronës (përqëndruar tek kompensimi dhe rikthimi i saj);
4. E drejta për jetë të sigurt dhe kufizimi i ligjshëm i lirisë (me fokus tek siguria në burgje ose institucionet e mbyllura; garantimi i sigurisë në komunitet, etj.)
5. E drejta për pjesëmarrje në jetë publike dhe konsultimi publik (p.sh. proceset e vendimmarrjes, e drejta e votës);
6. E drejta e aksesit në drejtësi (në fokus grupet e marginalizuara);
7. E drejta e barazisë dhe mosdiskriminimit (me fokus minoritetet, fëmijët, LGBTIQ+ dhe gratë);
8. E drejta për ujë të pastër e të pijshëm (me fokus tek zonat rurale);
9. E drejta për akses në edukim dhe arsim cilësor (me fokus tek zonat rurale).

Të dhënat cilësore dhe sasiore të Barometrit lidhur me këto të drejta janë mbledhur dhe përpunuar me anë të kryqëzimit të informacionit të siguruar me anë të këtyre burimeve:

- **Anketimi i qytetarëve:** Të dhëna mbi respektimin e të drejtave të mbledhura nga intervistimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve, të grupuar sipas target grupeve të përcaktuara për secilën nga 9 të drejtat;
- **Informacion nga institucionet shtetërore:** Të dhëna zyrtare nga institucionet përgjegjëse;
- **Hulumtim:** Të dhëna të mbledhura nëpërmjet një hulumtimi online apo nëpërmjet të dhënave të evidentuara nga raporte dhe studime të tjera të KShH-së.

¹ ‘Monitorimi i të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet fuqizimit të mbrojtësve lokalë të të drejtave të njeriut (HRD) përmes sesioneve të punës, misionëve të përbashkëta të monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave fillestare’

Të dhënat e anketimit mbi perceptimet e qytetarëve janë mbledhur nëpërmjet një pyetësi i cili është ndarë në 8 seksione të ndryshme. Secili prej seksioneve ka si qëllim të masë perceptimin mbi respektimin e njërës prej 8 të drejtave të listuara më sipër, duke përjashtuar jetën dhe sigurinë e saj nga kjo tipologji monitorimi. Në bazë të të drejtës që pyetësi synon të adresojë, është përzgjedhur edhe grupi i interesit tek i cili pyetësi është shpërndarë. Për këtë arsye, siç vihet re në secilin kapitull më poshtë, për analizën e secilës prej të drejtave, kampioni i anketuar është i ndryshëm.

Pyetësi u shpërnda në rrugë elektronike në formatin *Google Form*, nëpërmjet pikave të kontaktit të KShH në qytete të ndryshme të vendit, si dhe pjesëmarrësve në sesionet e punës të organizuara në kuadër të këtij projekti, me mbrojtës të të drejtave të njeriut. Pyetësorët janë plotësuar nga një numër prej 5,002 shtetasish. KShH nuk përjashton mundësinë që i njëjti shtetas të ketë plotësuar më shumë se një nga pyetësorët që janë pjesë e këtij barometri.

Përzgjedhja e pjesëmarrësve në anketë

Përzgjedhja e të anketuarve është kryer kryesisht në mënyrë përfaqësuese të përzierë me përzgjedhje të rastësishme, për të siguruar kështu që kampioni të jetë përfaqësues i popullatës të ndarë sipas qarqeve në funksion të metodologjisë. Paraprakisht, KShH, realizoi një planifikim mbi metodologjinë dhe kuotat e parashikuara për secilin rajon gjeografik në vend bazuar mbi të dhënat e popullsisë në rajonet që ishin në vëmendje të pyetësit. Vlen për t'u përmendur se, si çdo formë pune kërkimore, dhe ky proces u karakterizua nga limite (p.sh. pamundësia për të arritur numrin e duhur të shtetasve me vendbanim në Qarkun Lezhë) të cilat, në përfundim, impaktojnë dhe rezultatet fundore të tërësisë së të dhënave.

Mbledhja e të dhënave u zhvillua *online* me anë të platformës elektronike *Google Form*. Gjatë mbledhjes së të dhënave, KShH evidentoi se pyetësi është anonim dhe se pjesëmarrja në anketë ishte vullnetare. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, asnjë e dhënë personale nuk do të shpërndahet nga KShH dhe informacioni i dhënë anketimit do të përdoret vetëm për qëllime të analizës së të dhënave në këtë studim.

Anketimi u realizua me individë të moshës mbi 18 vjeç. KShH zhvilloi një analizë paraprake duke marrë në konsideratë shpërndarjen në përqindje të popullsisë në territorin e Republikës së Shqipërisë të cilët i përkasin kësaj kategorie moshe.

Në sondazh u gjeneruan gjithsej 5,002 përgjigje nga personat të cilët u anketuan për secilin prej seksioneve. Në bazë të të dhënave, për secilin seksion u anketuan:

- Në seksionin 'E drejta për një standard jete dinjitoze' morën pjesë 751 të anketuar
- Në seksionin 'E drejta e punës' u anketuan 658 individë
- Në seksionin 'E drejta e pronës' morën pjesë 542 të anketuar

- Në seksionin ‘Pjesëmarrja në jetën publike dhe konsultimi publik’ u anketuan 729 qytetarë
- Në pyetësin për seksionin ‘Aksesi në drejtësi’ morën pjesë 612 persona
- Në pyetësin për seksionin ‘Barazia dhe mosdiskriminimi’ morën pjesë 630 të anketuar
- Në seksionin ‘E drejta për ujë të pastër e të pijshëm’ u anketuan 550 individë, dhe
- Për seksionin ‘E drejta për akses në arsim dhe edukim cilësor’ të dhënat u gjeneruan nga 531 të anketuar.

Në përgjithësi, secili prej seksioneve të pyetësit ka për qëllim të mbledhë të dhëna mbi:

- Nivelin e informacionit që të anketuarit kanë mbi kuadrin ligjor në fuqi i cili garanton respektimin e të drejtës të cilën pyetësi synon të adresojë;
- Aksesin që të anketuarit kanë në ushtrimin e mjeteve ligjore dhe pranë inëstitucioneve të cilat sigurojnë respektimin e këtyre të drejtave;
- Perceptimin mbi masat e marra nga institucionet shtetërore për garantimin e këtyre të drejtave.

Të dhënat në Kreun II të këtij raporti, janë mbledhur si rezultat i misionëve të vëzhgimit të realizuara nga monitoruesit e të drejtave të njeriut, kapacitetet e të cilëve u fuqizuan prej KShH-së, si dhe korrespondencës zyrtare të realizuar me institucionet kyçe për adresimin e problematikave të ndryshme që ky raport analizon.

I. E DREJTA PËR NJË STANDART JETE DINJITOZE

Informacion i përgjithshëm për të anketuarit

Në anketim u përfshinë 751 individë nga të cilët 51.7% i përkasin gjinisë femërore dhe 47.8% gjinisë mashkullore. Rreth 0.5% e të anketuarve (4 persona) preferojnë të mos e japin këtë informacion.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve






Figura 2. Përfaqësimi i anketuarve sipas moshës



Gjatë mbledhjes së të dhënave, përfshirja e të gjithë grupmoshave ka patur rëndësi të veçantë. Kështu, siç vihet re në figurën 2, pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 36-45 vjeç (24.3%); 18-25 vjeç (23.7%), 26-35 vjeç (22.2%) dhe 46-55 vjeç (15.8%) duke përbërë kështu pothuajse 86% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë kategorinë më pak të përfaqësuar në anketim me vetëm 6.2% të individëve të anketuar.



Sa i takon nivelit arsimor të të anketuarve, shumica e tyre ose afro 47.9% janë me arsim të lartë universitar dhe/ose pasuniversitar, ndjekur nga 29.7% që kanë mbaruar gjimnazin. Pjesa tjetër e të anketuarve kanë arsim të mesëm të ulët (8.7%), 12.3% të anketuar me arsim profesional dhe 1.4% kanë arsim fillor.

Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas nivelit arsimor

Figura 4. Përfaqësimi mbi marrëdhëniet e punësimit të të anketuarve



Vërehet se shumica e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat (31,5%) ndjekur nga të punësuarit në institucione publike (23.7%). Të vetëpunësuarit përbëjnë 18,5 % të të anketuarve, kundrejt personave të cilët janë të papunë që përfaqësohen në masen 15.5% të kampionit të anketuar. Gjithashtu pjesëmarrës në anketim kanë qënë edhe studentët ku rezulton se 1 në 10 të anketuar

ose 10.8% i përket kësaj kategorie.

Përfaqësimi i të anketuarve sipas vendbanimit evidenton se, qarku Tiranë përmban përqindjen më të lartë të të anketuarve (32%) ndjekur nga qarku Durrës (11.6%). Qarku Elbasan përfaqësohet nga 10.5% të të anketuarve ndjekur nga qarku Shkodër me 10% të të anketuarve. Pjesa më e vogël e të anketuarve është e përqendruar në Lezhë përfaqësuar nga vetëm 1 i anketuar.




Figura 6. Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut

Gjetjet Kryesore: E drejta për një standart jete dinjitoze

Lidhur me të drejtën e çdo njeriu për një standart jete dinjitoz, KShH synoi të mbledhë të dhëna mbi të gjitha mbi kushtet e strehimit si dhe standardet minimale të jetesës së të anketuarve, bazuar në kuadrin ligjor² në Republikën e Shqipërisë i cili garanton respektimin e kësaj të drejte. Duke marrë në konsideratë rritjen e kostove të jetesës dhe ndikimin e menjëhershëm në sigurimin e një standarti dinjitoz të jetës së qytetarëve, KShH pyeti të anketuarit fillimisht sa i takon të ardhurave të tyre mujore.




Figura 7. Sa janë të ardhurat tua mujore individuale?

Siç evidentohet në figurën 7, për një pjesë të konsiderueshme të të anketuarve (33%) të ardhurat mujore janë nën rrogën minimale ku 18% e tyre marrin më pak se 30,000 në muaj, kundrejt 15% të cilët kanë pohuar se nuk kanë asnjë të ardhur. Pjesa më e madhe e të anketuarve (37%) pohuan se kanë të

ardhura mesatare prej 30,001-50,000 lekë në muaj ndjekur nga një në tre persona (ose 30% e të anketuarve) të cilët pohuan se të ardhurat e tyre individuale janë mes 50,001-100,000 lekë në muaj.

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: neni 52, 55 dhe 59 i Kushtetutës; [Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore: neni 7, 11, 12 të paktit](#); [Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”](#); [Ligji nr 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”](#);

[Ligji 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”](#) dhe Ligji 121/2016 “ Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Figura 8. Sa përqind të të ardhurave mujore familjare, shpenzoni për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm (përballimi i strehimit)?

Duke vlerësuar se strehimi përbën një ndër kostot më të mëdha për një familje, të dhënat e anketimit nxjerrin në pah se rreth 60% e të anketuarve pohuan se nuk shpenzojnë për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm. Kjo mund të reflektojë disa tendenca të strehimit në vendin tonë të cilat mund të lidhen me trashëgiminë e pronave nga prindërit/të afërmit, jetesës së disa personave/familjeve në të njëjtën banesë, apo në raste më të pakta të strehimit social të ofruar nga institucionet shtetërore. Rreth 15% të të anketuarve pohonë se deri në 25% të të ardhurave të tyre mujore shkon drejt sigurimit të një strehimi të përshtatshëm.





Figura 9. A keni dijeni për programin social të strehimit që zbatohet në njësinë tuaj të vetëqeverisjes vendore, kushtet, procedurën dhe asistencën?



Rreth 20% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë interes për programet e strehimit duke treguar se strehimi i tyre është i siguruar nëpërmjet formave të tjera. Ndërkohë, pjesa tjetër e të anketuarve ndahet mes dy mendimeve ku 40% pohojnë se kanë dijeni rreth programeve sociale të strehimit dhe asistencës, kushteve dhe procedurave të lidhura me to, kundrejt 40% të cilët nuk kanë

dijeni.

Nëpërmjet pyetësorit të anketuarit u pyetën nëse këto programe zbatohen në mënyrë të barabartë ose jo. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 41% prej tyre pohojnë se programi i strehimit nuk zbatohet në mënyrë të barabartë, ndjekur nga 39% të cilët shprehën se nuk kanë informacion. Vetëm 1 në 5 persona (20%) pohuan se zbatimi i programit të strehimit social garanton barazi për të gjithë shtetasit në qytetin e tyre.




Figura 10. A mendoni se programi social i strehimit në njësinë tuaj të qeverisjes zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë shtetasit në qytetin tuaj?

Vërehet gjithashtu se nga të anketuarit, më shumë se 1 në 4 persona (23%), pohojnë se kanë aplikuar të paktën 1 herë për të qenë përfitues të programit të strehimit social, kundrejt 77% pjesëmarrësve në anketim të cilët mohojnë diçka të tillë (Fig 11).




Figura 11. A keni aplikuar ndonjëherë për të qenë përfitues i programit të strehimit social?





Figura 11.1 Nëse keni aplikuar për të qenë përfitues i programit të strehimit social, a keni qenë përfitues me strehim?



Nga personat që pohuan se kanë aplikuar për të qënë përfitues të programeve të strehimit social, rezultoi se në 20% të rasteve kanë përfituar strehim kundrejt 80% të tyre që nuk kanë përfituar prej këtyre programeve.

Figura 12. A e vlerësoni strehimin tuaj të përshtatshëm për një jetesë të qetë dhe dinjitoze?

Të anketuarit u pytën rreth sigurisë që u ofron strehimi i tyre dhe nëse banesa e tyre ishte e përshtatshme për një jetesë të

qetë dhe dinjitoze.

Shumica e të anketuarve (56%) vlerësojnë se strehimi i tyre është i përshtatshëm për një jetë dinjitoze, kundrejt 26% të tyre të cilët shprehen se nuk janë të sigurtë nëse strehimi i tyre ua ofron këtë mundësi. Pothuajse 1 në 5 persona (18%) shprehen se strehimi i tyre nuk është i përshtatshëm për një jetesë të qetë dhe dinjitoze.

Figura 13. A ju mundëson strehimi juaj siguri (p.sh. në të ardhmen nuk rrezikoni të jeni i pastrehë)?

Në pothuajse të njëjtat tendenca me të dhënat më lart, 56% të të anketuarve pohuan se banesa e tyre u ofron siguri se në të ardhmen nuk rrezikojnë të mbeten të pastrehë, ndjekur nga 24% e të anketuarve që pohuan të kundërt dhe 20% e të anketuarve të cilët nuk e dinë nëse banesa e tyre është e sigurtë apo jo.






Figura 14. Në strehimin/banesën tuaj, a ka lehtësi dhe hapësirë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët?



KShH vlerësoi perceptimet edhe mbi standartet e strehimit apo banesës së të anketuarve për grupet në nevojë. 33% e të anketuarve pohojnë se banesa e tyre ka lehtësira dhe hapësira të mjaftueshme e të përshtatshme që u përgjigjen nevojave të kategorive të tilla, ndjekur nga 26% të cilët pohojnë se pjesërisht këto lehtësi garantohen në banesën e tyre. Shqetësues është fakti se për 1 në 3 persona (30%) pohojnë se në fakt banesa e tyre nuk ka lehtësi apo hapësira për kategoritë në fjalë ndjekur nga 11% të cilët shprehen të pasigurtë.

Figura 15. A përfitoni nga shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve?



Akresi në shërbime publike si uji i pijshëm, energjia elektrike apo largimi i ujërave të ndotura e mbetjeve përbën një garanci për garantimin e një standarti të jetës dinjitoze. Shumica e të anketuarve (69%) e tyre, përfitojnë nga shërbime të tilla plotësisht. 24% e të anketuarve përfiton pjesërisht, kundrejt 7% të tyre të cilët pohojnë se nuk kanë akses në shërbime të tilla (Fig. 15). Nga të dhënat e ofruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjatë procesit të konsultimit të këtij raporti, rezulton se përfituesit e programit të asistencës sociale dhe aftësisë së kufizuar kanë të drejtën e përfitimit të kompensimit financiar për konsumin e energjisë elektrike. Gjithashtu për këto kategori vendosen pa pagesë matësit e ujit dhe lidhen pa pagesë kontratat me ujësjellës-kanalizimet.




Figura 16. Nëse jeni përfitues i shërbimeve publike të përmendura në pyetjen 11, a jeni të kënaqur me cilësinë e këtyre shërbimeve?

KShH vërejnë se shumica dërrmuese e të anketuarve janë plotësisht (41%) ose pjesërisht (43%) të kënaqur me shërbimet publike të përmendura më lart. Rreth 16% e qytetarëve pjesëmarrës në anketim pohojnë pakënaqësi sa i takon këtyre shërbimeve.

Një standard tjetër për një jetë të sigurtë e dinjitoze është aksesimi në mundësitë e punësimit. Në Shqipëri, punësimi vijon të mbetet problematik. Nga të dhënat e

të anketuarve rezultojnë 15.5 % janë të papunë, si dhe 10.8% studentë.

Figura 17. A keni informacion për shërbimet që ofrojnë punësim për ju në qytetin ku jetoni?

Shumica e të anketuarve pohuan se kanë informacion (33%) ose informacion të pjesshëm (32%) për shërbime të tilla kundrejt 22% të tyre që pohuan se nuk kanë dijeni për shërbimet e punësimit, ndërkohë 13% e tyre shprehën të painteresuar për këto shërbime duke treguar në mënyrë indirekte se kanë një punësim të sigurtë aktualisht.






Figura 18. A keni aplikuar për të përfituar nga shërbimet e punësimit?



Në reflektim të një trendi të ngjashëm me përgjigjet e dhëna më herët, rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve, 73% e tyre nuk kanë aplikuar për të përfituar nga shërbimet e punësimit kundrejt 27% të tyre të cilët pohuan se kanë aplikuar për të përfituar nga shërbimet e punësimit.

Figura 18.1. Nëse keni aplikuar në shërbimet e punësimit, a keni qenë përfitues?

Shumica e personave të cilët kanë aplikuar për të përfituar nga shërbimet e punësimit rezulton se



nuk kanë qenë përfitues (72%), në krahasim me 28% të cilët pohuan se kanë aplikuar dhe kanë përfituar nga këto programe. Aksesin në shërbimet për kujdesin shëndetësor dhe social është një aspekt tjetër që garanton një standard më të mirë jetese. Për të përfituar nga shërbime të tilla është e domosdoshme që qytetarët të jenë të mirëinformuar. Sipas të dhënave të marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë

procesit të reformimit të skemës së ndihmës ekonomike janë kryer disa fushata ndërgjegjësuere, të cilat mund të kontribuojnë në përmirësimin e kësaj situatë.

Figura 19. A keni dijeni për shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social?

Lidhur me dijeninë rreth këtyre shërbimeve, nga të dhënat e pyetësorit rezulton se më shumë se 80% e të anketuarve kanë dijeni (52%) ose informacion të pjesshëm (30%) rreth kujdesit shëndetësor apo social. Vetëm 18% e të anketuarve pohuan se nuk kanë dijeni për shërbimet e kujdesit shëndetësor ose social në vendbanimin e tyre (Fig 19).






Figura 20. A keni dijeni për mundësinë dhe kushtet e përfitimit të asistencës sociale, ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësinë e kufizuar?



Rreth 71% e të anketuarve kanë dijeni për kushtet rreth asistencës sociale apo ndihmës ekonomike duke evidentuar një nivel ndërgjegjësimi të mirë rreth këtyre shërbimeve, kundrejt 29% të cilët nuk kanë informacion.

Figura 21. A jeni apo keni qenë përfitues i asistencës sociale, ndihmës ekonomike ose pagesës së aftësisë së kufizuar?



79% e të anketuarve pohuan se nuk janë apo kanë qënë përfitues të ndihmave të tilla, ndjekur nga 9% e të anketuarve që pohuan se kanë qënë përfitues në të kaluarën, kundrejt 12% të tyre të cilëve janë përfitues aktualisht.

Figura 22. A janë/kanë qenë përfitues të këtyre ndihmave (asistencës), familjarët tuaj me të cilët jetoni?

Në pothuajse përqindje të njëjta raportohet edhe për familjarë të cilët janë ose kanë qënë përfitues të këtyre ndihmave. 72% e të anketuarve pohuan se familjarët e tyre nuk kanë përfituar asistencë sociale apo ndihmë ekonomike, ndjekur nga 16% e tyre që aktualisht janë përfitues të këtyre ndihmave dhe 12% të cilët pohuan se nuk kanë qenë përfitues në të kaluarën.






Figura 23. Si e vlerësoni nivelin e asistencës sociale, ndihmës ekonomike ose pagesës për aftësinë e kufizuar për nevojat e kategorive që kanë të drejtë ta përfitojnë atë?

Gjithashtu, KShH vëren se shumica e qytetarëve të anketuar të cilët më herët kanë pohuar se janë përfitues të ndihmës sociale (49%) referojnë se mbështetja e tyre është aspak e mjaftueshme, në raport me nevojat që kanë, edhe pse gjatë viteve të fundit ka patur rritje të masës së

përfitimit të këtyre pagesave. Vetëm 20% e të anketuarve, pohojnë se këto të ardhura janë të mjaftueshme për t’ju përgjigjur nevojave të individëve përfitues.

Figura 24. Nëse keni aplikuar për të qenë përfitues i asistencës sociale, ndihmës ekonomike ose pagesës për aftësinë e kufizuar dhe kjo e drejtë ju është refuzuar, a ju është sqaruar ky vlerësim në mënyrë të qartë dhe të plotë nga institucionet?

Vetëm 15% e të anketuarve kanë marrë një sqarim të qartë dhe të plotë nga institucionet në rastet kur e drejta për të përfituar nga asistenca sociale, ndihma ekonomike apo pagesat lidhur me aftësinë e kufizuar j’u është refuzuar.



STREHIMI SOCIAL DHE MENAXHIMI I BANESAVE SOCIALE, BASHKIA KORÇË

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH-së, në Shkurt 2024 realizuan një mision monitorues në qytetin e Korçës qëllimi i të cilit ishte për të vrojtuar ecurinë e procesit të strehimit social. E drejta e strehimit garantohej në nenin 59 të Kushtetutës së Shqipërisë ku parashikohet se *‘shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim.’*

MDNJ-të konstatuan se procedura që ndiqet për përfitimin e strehimit social kryhet online në sistemin e strehimit nëpërmjet platformës qeveritare e-Albania. KShH vlerëson se aksesimi në shërbimet digjitale mund të jetë i pabarabartë ndër qytetarët e bashkisë Korçë ndaj i rekomandon institucioneve përgjegjëse të ndërmarrin fushata informimi për qytetarët si dhe t’u ofrojnë atyre mbështetje dhe asistim gjatë procesit të aplikimit.

MDNJ-të, konstatuan se numri i personave të regjistruar si të pastrehë në bashkinë Korçë është përafërsisht 1350 familje në vitin 2023, ndërsa rezulton se nga zbatimi i programeve të strehimit kanë përfituar 129 familje. Kjo tregon për një proces të ngadaltë ku shumica e personave të pastrehë nuk përfitojnë nga programi i strehimit.

Bashkia Korçë pohoi se veprimtaria për sistemim dhe akomodim realizohet në bazë të kërkesave si dhe në bazë të planit lokal 5 vjeçar 2021-2026 për strehimin social dhe ndërthuret edhe me punësimin e qytetarëve. Kategoritë e personave përfitues të skemës së strehimit social përfshijnë personat me aftësi të kufizuara; familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirit të banesave të ish-pronarëve, familjet e komunitetit Rom & Egjiptian; prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë, me të ardhura shumë të ulta; familje te reja; individët me moshë nën 40 vjet, të moshuarit dhe komunitetet nga zonat rurale.

KShH vëren se ndërsa këto kategori janë vetëm disa prej kategorive të parashikuara në ligj, pjesa tjetër e kategorive si viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, individët që i përkasin komunitetit LGBTI, familjet e policëve të rënë në detyrë etj nuk rezultojnë të jetë përfitues të këtij shërbimi publik.

MDNJ-të konstatuan gjithashtu se sfida kryesore për strehimin në bashkinë Korçë është përballimi i nevojave për strehim të kategorive vulnerabël me sistemim në banesa sociale që ofrojnë një strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe në përputhje me të drejtat për të patur akses për shërbime në arsimim, shërbime shëndetsore, infrastrukturë e shërbime komunale. Nga këqyrja e ambienteve të banesave sociale, MDNJ-të vërejnë se banesat janë në kushte jo të mira me lagështirë të theksuar dhe myk për shkak të mungesës së hidroizolimit të ndërtesës.

Sa më sipër, KShH vlerëson se situata paraqitet tejet emergjente dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme të Bashkisë Korçë për parashikimin buxhetor dhe planifikimin e rikonstruktimit të banesave sociale ekzistuese si dhe ndërtimin e banesave të reja për adresimin e kërkesave për strehim të kategorive në nevojë.

II. E DREJTA E PUNËS

Informacion i përgjithshëm për të anketuarit

Në anketim u përfshinë 658 individë nga të cilët 51.4% i përkasin gjinisë femërore dhe 48% gjinisë mashkullore. 0.6% e pjesëmarrësve kanë zgjedhur si alternativën ‘Tjetër’ sa i përket gjinisë.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve






Figura 2. Përfaqësimi i anketuarve sipas moshës




Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 26-35 vjeç (26.6%), 36-45 vjeç (23.2%) dhe 18-25 vjeç (22%), të cilët në total përbëjnë pothuajse 71.8% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë kategorinë më pak të përfaqësuar në anketim me vetëm 5.2% të individëve të anketuar.

Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas nivelit arsimor



Sa i takon nivelit arsimor të të anketuarve, shumica e tyre ose 47.1% janë me arsim të lartë universitar ose pasuniversitar, ndjekur nga 29% që kanë arsim të mesëm dhe 12.3% të cilët kanë arsim profesional. Kategoritë më pak të përfaqësuar në anketë mbeten të anketuarit pa asnjë nivel arsimor fillor (0.7%).


Figura 4. Përfaqësimi i punësimit të të anketuarve



Pjesa më e madhe e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat (49%) duke e bërë grupin më të përfaqësuar në këtë anketë, ndjekur nga 21% të cilët punojnë në një institucion shtetëror. Pjesa tjetër e të anketuarve përbëhet nga të vetëpunësuarit (12%), të papunët (10%) dhe studentët (8%).

Figura 6. Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut

Qarku Tiranë përmban përqindjen më të lartë të të anketuarve (23.6%) ndjekur nga qarqet më të mëdha në vend Durrës (12.8%), Shkodër (11.8%) dhe Dibër (11.4%). Pjesa më e vogël e të anketuarve është e përqendruar në Lezhë (0.4% e tyre).




Gjetjet Kryesore: E drejta e punës

Ky seksion i pyetësorit synon të mbledhë të dhëna në lidhje me respektimin e kushteve të punës në sektorë si: fasoneritë, *call centers*, minierat dhe mediat, në përputhje me kuadrin tonë ligjor³.

³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: Kreu IV i Kushtetutës, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore: neni 6, 7, 8 i Paktit, Kodi i Punës.

Figura 8. A ju është kërkuar ndonjëherë të punoni në mënyrë të rregullt pa një kontratë?



KShH i pyeti të anketuarit nëse u është kërkuar ndonjëherë të punojnë në mënyrë të rregullt pa një kontratë. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se shumica e të anketuarve (59%) pohojnë se nuk u është kërkuar një gjë e tillë ndjekur nga 41% të cilëve u është kërkuar të punojnë pa një kontratë me punëdhënësin.

Figura 9. Nëse jeni i punësuar, a keni aktualisht një kontratë të shkruar sipas Kodit të Punës?

Shumica e të anketuarve ose 62% e tyre pohojnë se kanë një kontratë pune me shkrim në përputhje me parashikimet e Kodit të Punës, neni 21 i të cilit parashikon se ‘Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar.’ Megjithatë më shumë se 1 në 5 persona ose 22% e të anketuarve pohuan se nuk kanë një kontratë me shkrim me punëdhënësin, ndërkohë që 17% e të anketuarve pohuan se janë të papunë.




Figura 10. Cila është kohëzgjatja e kontratës tuaj aktuale (ose e kontratës së fundit që kishit)?

Sa i takon kohëzgjatjes së kontratës së punës, KShH gjithashtu vëren se 51.5% e të anketuarve janë të punësuar me një afat të pacaktuar të kontratës, ndjekur nga 15.7% të cilat janë të kontraktuar për një periudhë 1-3 vite dhe 15.4% e të anketuarve të cilët ju përgjigjën kësaj pyetje pohojnë se nuk kanë patur asnjëherë një kontratë të shkruar. Kjo e dhënë është kontradiktore me të dhënat më sipër ku 22% e të anketuarve kanë pohuar se nuk kanë kontratë me shkrim me punëdhënësin.





Figura 11. A ju është kërkuar ndonjëherë të nënshkruani një kontratë punësimi pa u lexuar të lexoni dhe kuptoni termat e kontratës para se ta nënshkruani?



Për pjesën më të madhe të të anketuarve, kushtet e kontratës kanë qënë të qarta dhe nuk u është kërkuar të nënshkruajnë kontratën pa i lexuar ato. Ndërkohë 22% e të anketuarve pohuan se u është kërkuar të nënshkruajnë një kontratë punësimi pa patur mundësi të lexojnë kushtet e kontratës.

Figura 12. Mesatarisht, sa orë në ditë punoni?

Gjysma e të anketuarve (50%) pohojnë se punojnë rreth 8-9 orë në ditë, ndjekur nga 17% të cilët punojnë për rreth 4-7 orë çdo ditë, në krahasim me 12% të të anketuarve që pohojnë se punojnë mbi 10 orë në ditë⁴.





Figura 13. Aktualisht, çfarë page merrni ju çdo muaj (neto në lekë)?



Duke filluar nga muaji Mars 2023, paga minimale aktuale në Shqipëri është 40 000 Lekë në muaj. KShH vëren se 2% e të anketuarve paguhen me një pagë nën masën 30,000 lek, ndërkohë që 6% e tyre paguhen në masën 30,000 - 35,000 Lek. Pjesa më e madhe e të anketuarve paguhen nga 35.000-100.000 lekë ndërkohë vetëm 2% e të anketuarve marrin më shumë se 100.000 lekë pagë mujore. Këto të dhëna tregojnë se shumica dërrmuese e të anketuarve janë me një pagë relativisht mesatare.

⁴ Në nënin 78 të Kodit të Punës parashikohet se 'Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive, ose në kontratën individuale të punës, brenda limiteve të kohës javore maksimale të punës'.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (56%) pohuan se paguhen vetëm nëpërmjet bankës. Kjo mënyrë pagese siguron më shumë transparencë për detyrimet e secilës palë si dhe detyrimet për kontributet të cilat paguhen institucioneve shtetërore (taksa, tatime, sigurime shoqërore e shëndetësore). Për 24% prej tyre, pagesa bëhet në kushte të plota ose të pjesshme të informalitetit (13% e të anketuarve pohojnë se paguhen me para në dorë ndjekur nga 11% të cilët pohojnë se paguhen pjesërisht me bankë dhe pjesërisht me para në dorë.




Figura 15. A i deklaron punëdhënësi juaj autoriteteve shtetërore pagën reale që keni marrë?

Duke vlerësuar se disa forma të kalimit të pagës mujore janë më transparente se të tjerat, KShH i pyeti të anketuarit edhe nëse punëdhënësi i tyre bënte deklaram real të pagës së tyre pranë autoriteteve shtetërore. Gjysma e të anketuarve (50%), pohojnë se deklarohet paga reale, ndjekur nga pothuajse 1 në 4 persona (24%) të cilët nuk kanë informacion lidhur me pyetjen. 7% e të anketuarve pohojnë se paga e tyre reale nuk deklarohet nga punëdhënësi pranë autoriteteve shtetërore.




Figura 16. A ju ka kërkuar ndonjëherë punëdhënësi të ktheni mbrapsht pranë tij një pjesë të pagës tuaj?

KShH gjithashtu vëren se në shumicën e rasteve (75%) të anketuarit pohojnë se nuk u është kërkuar të kthejnë mbrapsht një pjesë të pagës së tyre. Megjithatë, një pakicë prej 6% e të anketuarve pohojnë se u është kërkuar nga punëdhënësi të kthejnë një pjesë të pagës që marrin shpesh herë (2%) ose në raste të rralla (4%).

Figura 17. Zakonisht si jeni kompensuar për punë jashtë orarit?⁵

Nga të dhënat e mbledhura vihet re se 42.4% e të anketuarve nuk marrin kompensim shtesë përtej pagës së tyre mujore. Megjithatë rezulton se 16.87% e të anketuarve janë kompensuar për orët shtesë me të njëjtën normë si paga e tyre ose normë më të lartë pagese. Ndërkohë që 9.88% e të anketuarve pohojnë se punën jashtë orarit e kanë kompensuar me ditë pushimi përkundrajt 11.85% të të anketuarve të cilët pohojnë se nuk punojnë jashtë orarit.






Figura 18. Në punën tuaj, a keni të drejtë për ndonjë nga përfitimet e mëposhtme?

61% e të anketuarve pohuan se përfitojnë sigurimin shëndetësor dhe sigurimet shoqërore nga punëdhënësi. 13% e të anketuarve nuk kanë dijeni dhe 7% e tyre pohojnë se nuk përfitojnë asnjë prej tyre.



⁵ Kodi i Punës parashikon në nenin 88 se ‘me orë shtesë kuptohet çdo orë pune e kryer mbi kohëzgjatjen ditore normale ose javore maksimale të punës.’ Punëdhënësi për orët shtesë të punës mund të kompensojnë punëmarrësin me një shtesë jo më pak se 25 për qind të pagës ose me një pushim të paktën 25 përqind më të madh, që i korrespondon kohëzgjatjes së orëve shtesë.

Figura 19. Sa ditë pushimi vjetor përfitoni sipas marrëdhënies së punës? (dita e shtunë dhe e dielë nuk konsiderohet si pushim vjetor).⁶



27% e të anketuarve përfitojnë 16-22 ditë pushimi vjetor, ndjekur nga 20% të të anketuarve që përfitojnë 5-10 ditë pushime. 12% e të anketuarve marrin mbi 22 ditë pushime vjetore, ndërkohë që 5% e të anketuarve pohuan se nuk përfitojnë asnjë ditë pushimi vjetor.

Figura 20. A ju është mohuar ndonjëherë e drejta për të marrë leje shëndetësore, pushime vjetore apo për festa kombëtare, sipas Kodit të Punës?

Rreth 46% e të anketuarve pohuan se nuk u është mohuar e drejta për të marrë leje shëndetësore, pushime vjetore apo pushimet për festa kombëtare. 18% e të anketuarve pohojnë se u është mohuar kjo e drejtë ndjekur nga e njëjta përqindje e të anketuarve (18%), të cilët pohojnë se rrallë herë u është mohuar e drejta për të marrë leje apo pushimet vjetore.





Figura 21. A mendoni se shëndeti apo siguria juaj është në rrezik për shkak të punës tuaj?



Rreth gjysma e të anketuarve (49%) pohojnë se shëndeti dhe siguria e tyre nuk është në rrezik për shkak të punës. 19% e të anketuarve gjithashtu mendojnë se puna e tyre pjesërisht i vë në rrezik shëndetin apo sigurinë e tyre. Vetëm 14% e të anketuarve pohuan se ndihen të rrezikuar për shëndetin dhe sigurinë e tyre për shkak të punës që bëjnë.

⁶ Sipas Kodit të Punës, kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike ose 22 ditë pune gjatë vitit të punës në vazhdim.

Figura 22. Për cilat arsye ndiheni të rrezikuar (mund të zgjidhet më shumë se një alternativë)?

14% e të anketuarve që ndihen të rrezikuar për jetën dhe sigurinë e tyre u pyetën lidhur me arsyet. 62% e tyre u shprehën se ndihen të rrezikuar për shkak të cilësisë së keqe të ajrit, ndjekur nga 11% të cilët rrezikohen për shkak të ngritjes së objekteve të rënda. 13% e tyre gjithashtu pohojnë se prania e kimikateve të ndryshme në punën e tyre i bën të ndihen të rrezikuar. Ndërsa 5% kanë preferuar të mos përgjigjen, rreth 9% e të anketuarve pohuan se ishin shkaqe të tjera të cilat i bënë të ndiheshin të rrezikuar si mbajtja për një kohë të gjatë e kufjeve; niveli i lartë i stresit; qëndrimi ulur para kompjuterit për kohë të gjatë; mungesa e higjienës; puna në errësirë për kohë të gjatë dhe shembjet e tokës për personat të cilët punojnë minatorë etj.






Figura 23. A janë kushtet e punës dhe ngarkesa të përballueshme dhe në përputhje me punën/detyrën specifike?



Për 36% të të anketuarve, kushtet e punës dhe ngarkesa në punë janë të përballueshme dhe në përputhje me punën/detyrën specifike që kryejnë, ndjekur nga 30% e të anketuarve të cilët pohojnë se kushtet e tyre të punës janë pjesërisht të përballueshme. Për 13% të të anketuarve ngarkesa dhe kushtet në punë janë të papërballueshme dhe jo në përputhje me detyrën që kanë.

Figura 24. Në dijeninë tuaj, cilat nga kategoritë e mëposhtme janë të organizuara në një sindikatë për mbrojtjen e të drejtave në punë

Pjesa më e madhe e të anketuarve, 35% e tyre nuk kanë informacion për organizimin në sindikata. Ndërkohë 31% pohojnë se në dijeninë e tyre minatorët janë të organizuar në sindikata ndjekur nga 20% të cilët mendojnë se edhe punonjësit e fasonerive kanë organizatën e tyre dhe 10% të cilët mendojnë se gazetarët dhe punonjësit e medias organizohen në sindikata për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Të anketuarit kanë pohuar gjithashtu edhe dijeni për sindikatën e mësuesve.



KShH vëren se 49% e të anketuarve pohojnë se sindikatat nuk japin rezultatin e dëshiruar (26%) ose i japin pjesërisht (23%), ndjekur nga 35% e tyre të cilët pohojnë se nuk kanë informacion, ndërkohë që 16% e të anketuarve pohojnë se janë besues ndaj sindikatave. Në tërësi nisur nga roli i rëndësishëm që ato kanë në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve në një shoqëri demokratike është shqetësues fakti mbi këto të dhëna, të cilat flasin për 84% të të anketuarve që nuk kanë besim, ose kanë pjesërisht besim ose nuk kanë asnjë njohuri për rezultatet e sindikatave. Nga të dhënat e pyetësorit gjithashtu vihet re se 81% e të anketuarve nuk janë anëtarë aktivë në ndonjë sindikatë që përfaqëson profesionin e tyre. Rreth 1 në 10 persona (11%) pohon se është anëtar aktiv në sindikata ndjekur nga 8% të cilët pohojnë se kanë qënë anëtarë të sindikatave për mbrojtjen e të drejtave të tyre por nuk janë më.




Figura 27. A vlerësoni se japin rezultatet e duhura këto sindikata në mbrojtjen e të drejtave tuaia në punë?




Figura 28. A jeni ju anëtar aktiv i një prej sindikateve të përmendura më sipër apo sindikatave të tjera?

MONITORIMI I RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË PUNONJËSVE TË FASONERIVE, CALL CENTER, MINIERAVE DHE MEDIAS

Me anë të Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut (MDNJ), KShH monitoroi respektimin e të drejtave të punëtorëve, me fokus sektorë të fasonerive, *call centers*, minierave dhe medias. MDNJ-të zhvilluan takime individuale me kryetarët/përfaqësuesit e sindikatave për këta sektorë.

Në aspektin metodologjik, informacioni i përpunuar dhe analizuar në kuadër të këtij monitorimi është mbështetur në takimet e zhvilluara me përfaqësues të Sindikatave ose Organizatave të secilit sektor, në korrespondencën me anë të kërkesave për informacion që KShH ka realizuar me entitete të tilla si Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Përveç veçorive dhe ngjashmërive që paraqet secili sektor në drejtim të problematikave sa i takon kushteve në punë dhe të drejtave të punës, mbetet i një rëndësie të veçantë nevoja për organizime të forta sindikale për të adresuar në rrugët e duhura ligjore këto shqetësime. Në Shqipëri, vihet re prezenca edhe e kompanieve të huaja që ushtrojnë presion apo diiskriminojnë punëtorët për të mos u anëtarësuar në sindikatë, veçanërisht në sektorin fason. Në një vend demokratik si Shqipëria, mungesa e një sindikate të medias është gjithashtu shqetësuese.

- **Sektori i Minierave**⁷

Problematikat kryesore me të cilat përballen punonjësit e sektorit të minierave janë si vijon:

- Siguria në punë:** Dhënia e një numri të madh licencash për të kryer punime nëntokë, ka bërë që hapja e galerive të kryhet pa pasur një studim fizibiliteti, çka ka vendosur në kushte shumë të vështira të sigurisë për jetën dhe shëndetin, punonjësit e sektorit të minierave. Si rrjedhojë, vlerësohet se kontrolli institucional për respektimin e kushteve të licencave dhe masave të sigurisë në punë është i pakët, duke bërë që të drejtat e minatorëve të shkelen veçanërisht nga shoqëritë tregtare që kanë një numër të ulët punonjësish. Sigurimi i jetës në disa raste nuk garantohet por edhe në ato raste kur ka një të tillë, shpërblimi nuk është proporcional me rrezikun dhe pasojat që mund të vijnë. Nga ana e punëdhënësve nuk ofrohen trajnime për sigurinë gjatë punës. Këto trajnime kryhen vetëm formalisht ku punëdhënësit i kërkojnë punëmarrësve të firmosin për kryerjen e trajnimit dhe njohjen me materialet trajnuese kur në fakt ata nuk e kanë marrë këtë trajnim. Lidhur me inspektimet

⁷ MDNJ-të zhvilluan takim me kryetarin e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, i cili referoi problematikat kryesore që kanë punëmarrësit në sektorin e minierave. Është marrë informacion nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë

dhe aksidentet në sektorin e minerave, autoriteti përgjegjës për sigurinë dhe emergjencat në këtë sektor (AKSE), informoi KSHH-në se gjatë periudhës katër vjeçare, Janar 2020 - Janar 2024, ka kryer gjithsej 2125 inspekte.⁸ Numri i aksidenteve për këtë periudhë është shumë i lartë, duke shënuar 79 raste të tilla⁹, 13 prej të cilave kanë rezultuar fatale me 16 jetë të humbura.¹⁰ AKSEM shprehet se nuk ka asnjë informacion për fshehje të aksidenteve në minierë. Në pak raste, referohet se raportimi për aksidentet ka qenë me disa orë vonësë, ose pas njoftimit të organeve të policisë. Në këto raste prej inspektorëve të AKSEM janë vendosur masa administrative me gjobë¹¹. AKSEM pohon se aktualisht janë 2 subjekte minerare me regjim gazi të cilat shtojnë riskun që ka puna në minierat nëntokësore. Sfidë sipas AKSEM janë investimet e sipërmarrësve në drejtimin e sigurisë e shëndetit, si dhe futja e teknologjive të reja për të lehtësuar punën e punonjësve të nëntokës.

- ii. **Mungesa e mjekëve në punë:** Përkundrejt rrezikut dhe shkallës së lartë të sëmundjeve profesionale që prek minatorët, vihet re se mjekët e punësuar nga punëdhënësi në këtë sektor nuk kanë kualifikimin e duhur për të trajtuar punonjësit.
- iii. **Të drejtat e punonjësve** - Shkeljet e të drejtave të minatorëve ndeshen më shumë tek shoqëritë tregtare që kanë një numër të ulët punonjësish dhe shtrihen në drejtim të pushimeve vjetore, sigurimeve shoqërore, procedurat dhe afatet e ndërprerjes së kontratave. Gjithashtu, ndikimi i sindikatave të punonjësve të minerave për përmirësimin e kushteve dhe të drejtave të punës është i munguar për këto shoqëri. Sindikatat e punonjësve të minerave kanë mundur të lidhin 4 kontrata kolektive, vetëm ndërmjet tyre dhe shoqërive më të mëdha të sektorit minerar. Shqetësues është fakti i mungesës së informacionit të punonjësve në këtë sektor lidhur me të drejtat e tyre sipas Kodit të Punës.
- iv. **Bashkëpunimi ndërmjet sindikatave të punonjësve të minerave dhe Inspektoratit të Punës nuk ekziston.** Shqetësues është fakti se kërkesat e dërguara nga KSSH ose sindikatat e tjera të sektorit minerar në lidhje me aksidentet e ndodhura në punë, pretendohet se në pjesën më të madhe të rasteve nuk regjistrohen nga Inspektorati. Në ato raste kur janë regjistruar, pretendohet se Inspektorati vendos që aksidentet nuk kanë ndodhur gjatë orarit të punës por jashtë tij.
- v. Sa i takon kontratave kolektive, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) shprehet se nëpërmjet Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Shqipërisë (anëtare e saj) ka

⁸ Viti 2020 - 494 inspekte; viti 2021 - 519 inspekte; viti 2022 - 518 inspekte dhe viti 2023 - 594 inspekte.

⁹ Viti 2020- 17 raste aksidente të raportuara; Viti 2021- 23 raste aksidente të raportuara; Viti 2022-16 raste aksidente të raportuara dhe viti 2023- 23 raste aksidente të raportuara.

¹⁰ Viti 2020: në 3 raste aksidente, 5 viktime; Viti 2021: 6 humbje jete; Viti 2022: në 3 raste aksidente, 4 viktime; Viti 2023: 1 aksidente me humbje jete.

¹¹ Bazuar në nenin 22, germa “b”, të ligjit 135/2016 datë 26.12.2016.

nënshkruar deri tani 117 kontrata kolektive në sektorin minerar. BSPSh shprehet se gjatë periudhës 2020-2023 për aksidente me pasoja vdekjen janë regjistruar për 15 punëmarrës, në vitin 2023 është regjistruar 1 rast. Gjatë periudhës 2021-2023, janë regjistruar 78 aksidente të përgjithshme.

2. Sektori i Operatorëve Telefonikë (Call Centers)¹²

Problematikat kryesore me të cilat këta punonjës përballen janë:

i. **Mungesa e njohjes së vjetërsisë në punë:** vjetërsia në punë për operatorët telefonik nuk njihet nga punëdhënësit, duke krijuar situata ku punonjësit e ri të shoqërisë paguhën në të njëjtën vlerë ose më shumë se punonjësit të cilët kanë punuar mbi 3 vjet në të njëjtën shoqëri. Në disa raste, për të evituar që punonjësi të mbush vitet minimale për të përfituar vjetërsinë në punë, e transferojnë atë punonjës në një shoqëri tjetër në vitin e 3 të punës.

ii. Rezulton se **punonjësit e call center nuk janë të mirë informuar mbi të drejtat e tyre** të garantuara nga Kodi i Punës, gjithashtu mbi përparësitë e anëtarësimit në sindikatë. Për këtë arsye SKOT ka marrë iniciativën për sensibilizimin e punonjësve në këtë drejtim.

iii. **Arritjet e lëvizjes sindikaliste** - Sindikata Kombëtare e Operatorëve Telefonikë (SKOT) po bën përpjekjet për të formalizuar një nismë ligjore pranë Kuvendit të Shqipërisë, për krijimin e statusit të veçantë për këta punonjës, sikurse është p.sh. statusi i minatorit. Kjo lëvizje vjen si rrjedhojë e vështirësitë që ka kjo natyrë pune, e cila bën të nevojshme daljen në moshë më të hershme në pension apo përfitimin nga bonuse të tjera.

SKOT referon se nuk ka më punësim informal në sektorin e *call centers*, në sajë të përpjekjeve që janë bërë të lidhur kontrata kolektive të favorshme midis punëdhënësve dhe punëmarrësve. Në lidhje me një rast specifik, SKOT ka ndjekur gjyqësish pranë gjykatës së arbitrazhit rastin kur shoqëria më e madhe në këtë sektor refuzonte lidhjen e kontratës kolektive. Për këtë çështje gjykata e arbitrazhit vendosi në urdhërimin e shoqërisë për të lidhur kontratën kolektive dhe në rast moszbatimi gjobitjen e saj. Sipas, kreut të SKOT, shoqëria ka lidhur kontratën kolektive ku përfshihen 20 punonjës, me një sindikatë të ndryshme nga SKOT, ku termat e kontratës nuk kanë asnjë avantazh me ato të kontratave individuale të punës. Ndër sfidat kryesore është se sindikata nuk ka mekanizma ligjore për të detyruar punëdhënësit për të lidhur kontratat kolektive. Ndërkohë rruga gjyqësore ka kosto të larta si në aspektin financiar dhe në kohë, ku përfundimi nuk garanton lidhjen e kontratës kolektive. Në disa raste të grevave të organizuara prej SKOT, punëdhënësit kanë larguar nga puna anëtar të sindikatës në mënyrë të menjëhershme, çështje të cilat janë ndjekur gjyqësisht.

¹² MDNJ-të zhvilluan takim me kryetarin e SKOT. Të dhënat e vendosura në dispozicion janë përmbledhur dhe analizuar në këtë seksion.

3. *Sektori i Fasonerive*¹³

Punonjësit e sektorit të fasonerive ndeshen më shumë me problematika në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre si dhe kushtet e punës, sipas parashikimeve të Kodit të Punës. Problematikat me të cilat ato ndeshen janë si më poshtë vijon:

- i. **Të drejtat e punonjësve:** Disa nga problematikat e referuara kanë të bëjnë me pasigurinë e punonjësve për vijueshmërinë e Kontratës së Punës, mosrespektimin e lejes vjetore, mospagimin në raste të caktuara të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagat e ulëta dhe jo motivuese, të cilat kanë pësuar rritje vetëm kur shteti ka ndërhyrë për rritjen e pagës minimale, mosnjohjen e punës jashtë orarit, mosnjohjen e vjetërsisë në punë, mbylljen e fasonerive pa realizuar njoftim paraprak ndaj punonjësve dhe në raste të tilla mos pagimi i pagave të mbartura, mosrespektimin e procedurave dhe afateve ligjore të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në rastet e reduktimit të numrit të punonjësve ose detyrimi për të dhënë dorëheqjen, mungesa e informacionit lidhur me kontratat nga punonjësit etj.
- ii. **Sfidat e lëvizjes Sindikaliste në këtë sektor** - Në disa raste, Sindikata ndjek largimet nga puna gjyqësish, por në shumicën e tyre, punonjësit e fasonerive kanë frikë apo tërhiqen nga pretendimet për shkak të frikës se vazhdimi i procesit gjyqësor do ti penalizojë për punësimin në vazhdim. Mes punonjësve referohet se mungon dëshira për të marrë pjesë në lëvizje sindikaliste dhe për t'u solidarizuar për kauzën e të drejtave të tyre në këtë sektor. SPF referon se punëdhënësi ushtron presion ndaj punonjësve që të mos ankohen te Sindikata dhe të pohojnë që janë të kënaqur me kushtet dhe të drejtat e tyre të punës¹⁴.

4. *Sektori i Medias*¹⁵

Punonjësit e sektorit të medias vijnë të përballen me disa problematika në drejtim të kushteve dhe të drejtave që ata duhet të gëzojnë konform parashikimeve në Kodin e Punës, të cilat përfshijnë:

- i. **Mungesa e një sindikate** - Pavarësisht përpjekjeve, në këtë sektor, në ndryshim nga tre sektorët e tjerë të përmendur më lartë ende nuk është krijuar një sindikatë për të përfaqësuar të

¹³ MDNJ-të zhvilluan takim me përfaqësuesen e Sindikatës së Punëtorëve të Fasonerive (SPF), e cila referoi problematikat kryesore që kanë punëmarrësit në sektorin e fasonerive.

¹⁴ Kështu p.sh., kur Sindikata zhvillon anketime të ndryshme ose në rastet kur nga punëdhënësi konstatohet se punëmarrësi ka patur kontakt me Sindikatën, punëdhënësi takon punëmarrësin për ta pyetur se çfarë ka përcjellë te sindikata.

¹⁵ MDNJ-të zhvilluan takim me Kryetarin e Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë.

drejtat e punonjësve të medias. Sipas kryetarit të Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë, pengesa për krijimin e sindikatave janë bërë punëdhënësit, të cilët nuk lejojnë që të ketë sindikata, pasi në momentin e paraqitjes së kërkesës për krijimin e sindikatës ata largojnë nga puna në mënyrë të menjëhershme, kërkesin ose persona të tjerë të interesuar, ose duke i diskriminuar ata në raport me punonjësit e tjerë.

ii. Të drejtat e punonjësve - Ndër problematikat më shqetësuese mbeten mungesa e kontratave kolektive si rrjedhojë e mungesës së sindikatës, mosrespektimi i procedurave dhe afateve ligjore të njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pamundësia e Unionit të Gazetarëve për t'i përfaqësuar në të tilla raste për shkak se nuk ka statusin e një sindikate, punësimi informal, operimi me kontrata shërbimi dhe jo pune kryesisht në rrjetin e reporterëve të rretheve, të cilët janë të detyruar të kryejnë punë të ndryshme dhe si rrjedhojë nuk ju paguhen sigurimet, moskonsultimi paraprak i kushteve kontraktuale me punonjësit, por imponimi i tyre nga punëdhënësi, mosnjohja e vjetërsisë në punë.

iii. Inflacioni i portaleve mediatike dhe mungesa e kontrollit nga institucionet - Në sektor pohohet se ka një inflacion të lartë mediash, ku sipas statistikave të Unionit rezultojnë 740 portale aktive, të cilat në disa raste i vonojnë punëmarrësve pagesat nga 2 deri në 3 muaj. Ky numër sipas Unionit krijon edhe vështirësi për monitorimin ose kontrollimin e tyre nga organet publike, duke bërë që shumë nga shkeljet e kryera nga punëdhënësit të mbeten të pazbuluara.

Duke u bazuar në shkeljet që referohen gjerësisht nga përfaqësuesit e sindikatave apo organizatave që mbulojnë 4 sektorët e mësipërm, shqetësues është fakti se një Institucion i rëndësishëm si Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore nuk rezulton se ka informacione statistikore apo cilësore mbi ankesat e depozituara nga punonjësit e fasonerive, minierave, *call centers* dhe medias. Argumenti i përdorur për mungesën e këtyre të dhënave është se klasifikimi i sektorëve bëhet sipas kategorisë së ILO-s (Organizata Ndërkombëtare e Punës). Në mënyrë objektive, perceptimi publik që krijohet është mosveprimi me efikasitet i këtij Inspektoriati për t'ju përgjigjur në mënyrë transparente dhe me llogaridhënie sfidave të sektorëve me vulnerabël në fushën e marrëdhënieve të punës.

AKSESI NË PUNËSIM NË QYTETIN E KUKËSIT

Aksesi në punësim është i rëndësishëm dhe ndërlidhet me standartin përshtatshëm të një jeteje të denjë. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH-së, me datë 7.02.2024 realizuan një mision monitorues në qytetin e Kukësit, qëllimi i të cilit ka qenë vëzhgimi i aksesit të qytetarëve të Kukësit në Agjencinë Kombëtare të Punësimit, si dhe në Zyrën Vendore të këtij qyteti. Gjithashtu, është vëzhguar niveli i informimit të qytetarëve në lidhje me këto institucione, mbi përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në lidhje me punësimin e qytetarëve të cilët nuk janë të punësuar.

MDNJ-të pranë KShH-së konstatuan se shërbimet pranë zyrave të formimit dhe trajnimit profesional, mundësojnë dhënien e informacionit të aksesueshëm për çdo individ, duke krijuar një mjedis të sigurt, të barabartë dhe mbështetës për të gjithë. Sfiduese për qytetarët mbetet mungesa e besimit tek institucionet publike mbi programet e punësimit që ofrohen, mungesa e informacionit mbi procedurat dhe dokumentacioni që duhet depozituar në plotësim të aplikimit, apo në pjesë fundore edhe keqpërdorimi i mundësisë që kanë qytetarët për t'u regjistruar si punëkërkuar të papunë me qëllim përfitimin e ndihmës ekonomike dhe bonuseve të tjera të ngjashme. Ndër 34 qytetarë të intervistuar nga vëzhguesit e KShH-së rezultoi se, 8 nuk pranuan të prononcohen në lidhje me punësimin; 10 prej tyre nuk kishin fare informacion, ndërsa 3 prej tyre u shprehën se “ky vend nuk bëhet më”. Duket se mungesa e kulturës së punësimit, e cila ka zgjatur për shumë kohë, ka sjellë një frymë pesimizmi dhe shkurajimi tek qytetarët. Kultura e punës është zëvendësuar me nevojën e pasurimit përmes emigracionit, ashtu si tendenca për t'u pasuruar shpejt nga ana e të rinjve.

Lidhur me këtë problematikë, KShH i rekomandoi institucioneve përgjegjëse përdorimin e teknikave dhe mekanizmave informues, nxitës dhe ndërgjegjësuar mbi të drejta që gëzojnë personat e papunë dhe pa të ardhura ekonomike, duke pasur gjithnjë tendenca më gjithëpërfshirëse, drejt një grupi më të gjerë të qytetarëve. Gjithashtu vlerësojmë se është me rëndësi hapja e programeve të reja të kurseve dhe trajnimeve profesionale me qëllim ofrimin e një larmishmërie të mundësive të reja të aftësimit profesional, duke u bazuar edhe në nevojat e tregut të punës. Me rëndësi është fokusi tek programet e aftësimit profesional që ofrojnë një standard dinjitoz jetese. KShH përcjell këtë rekomandim pasi mungesa e zgjerimit të shërbimeve përsa i përket shkollës së formimit profesional apo kurset e reduktuara vetëm në tre mundësi ofertash reduktojnë aksesin e një pjese të konsiderueshme të popullsisë.

MDNJ-të konstatuan se ka një përmirësim të aksesit të komunitetit ndaj shërbimeve. Kjo përfshin edhe përdorimin e teknologjisë dhe mënyrave të reja të komunikimit për të siguruar që edhe ata që jetojnë larg qendrës të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe aplikimin për punësim dhe trajnim profesional. Megjithatë, KShH vlerëson se ka një nevojë të dukshme që ky informacion të jetë më i arritshëm dhe rrjedhimisht më i përdorshëm për qytetarët.

KShH rekomandon që në kuadër të bashkëpunimit institucional ndërmjet strukturave shtetërore përgjegjëse për shërbimin social dhe të punësimit, është me rëndësi që procesi i punësimit të një personi të regjistruar si punëkërkuar i papunë, të mos mjaftohet vetëm me nënshkrimin e kontratës, por të gjenden mekanizma që garantojnë monitorimin sistematik të efektshmërisë së kësaj kontrate si dhe respektimin e të drejtave që rrjedhin nga legjislacioni i punës për këta shtetas. Ky rekomandim vjen si rrjedhojë e rasteve praktike, në të cilat jo pak kontrata kanë qenë fiktive.

III. E DREJTA E PRONËS

Informacion i përgjithshëm për të anketuarit

Në anketim u përfshinë 542 individë nga të cilët 55.9% i përkasin gjinisë mashkullore dhe 43.2% gjinisë femërore. Rreth 1% e të anketuarve (5 persona) preferojnë të mos e japin këtë informacion.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve





Figura 2. Përfaqësimi i anketuarve sipas moshës



Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 45-55 vjeç (23%); ndjekur nga grupmosha 36-45 vjeç (20%) dhe 56-60 vjeç (17.3%) të cilat përbëjnë pothuajse 60% të të intervistuarve. Të rinjtë e grupmoshave 18-25 vjeç dhe 26-35 vjeç përbëjnë përkatësisht 15% dhe 7% të të anketuarve.

Shumica e të anketuarve janë me arsim të lartë e më tej me 56%, ndjekur nga 22% që kanë nivel arsimor të mesëm të lartë dhe 13% të anketuar me arsim profesional. Kategoritë më pak të përfaqësuara në anketë mbeten të anketuarit me arsim fillor ose pa asnjë nivel arsimimi.

Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas Nivelit arsimor






Figura 4. Përfaqësimi i punësimit të anketuarve

54.7% e të anketuarve për këtë të drejtë janë të vetëpunësuar ose të punësuar në sektorin privat, duke e bërë grupin më të përfaqësuar në këtë anketë, ndjekur nga një pjesëmarrje pothuajse e barabartë midis të punësuarve në një institucion shtetëror (17.7%) dhe të papunëve (17.5%). Studentët përbëjnë një përqindje minimale të të anketuarve.




Qarku Tiranë përfaqësohet në anketim nga përqindja më e lartë e të anketuarve (28%) ndjekur nga qarqet Durrës dhe Shkodër me 14% të të anketuarve dhe Elbasani me 11 %. Pjesa më e vogël e të anketuarve është e përqendruar në Lezhë përfaqësuar nga vetëm 1 i anketuar.

Figura 6. Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut



Gjetjet Kryesore: E Drejta E Pronës

Ndryshimi nga regjimi totalitar komunist në regjimin demokratik nuk i mundësoi pronarëve të shpronësuar dhe trashëgimtarëve të tyre të fitonin në kohë, me cilësi dhe me procedura efikase të drejtat e tyre të humbura. Ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit dhe tendenca për të ulur vlerën e kompensimit të pronës dobësoi besimin e pronarëve tek procesi dhe tek autoritetet përgjegjëse për administrimin e tij. Në përputhje me legjislacionin në fuqi¹⁶ si dhe duke patur parasysh ndjeshmërinë dhe padrejtësitë me të cilat janë përballur gjatë këtyre 34 viteve të demokracisë, pronarët që kanë të drejtë të kompensohen apo t’ju kthehet prona e shtetëzuar, KShH realizoi këtë anketim, duke vendosur standarte hulumtuese konform këtyre parashikimeve.




KShH pyeti të anketuarit nëse u ishte shpronësuar apo marrë në përdorim prona private nga shteti. Më shumë se gjysma (56%) pohuan se u ka ndodhur një dukuri e tillë, kundrejt 44% të të anketuarve të cilët mohuan të jenë përballur me një çështje të tillë (Figura 7).

Figura 7. A ju është shpronësuar apo marrë në përdorim të përkohshëm pasuria juaj private për

interes publik nga shteti?

Figura 8. A keni realizuar ndonjëherë kërkesa për kthimin dhe/apo kompensimin e pronës së shtetëzuar?


Të anketuarit gjithashtu u pyetën nëse kishin bërë kërkesa për kthimin apo kompensimin e pronës së shtetëzuar. Njëjtë si trendi i mësipërm, 56% e të anketuarve pohuan se kanë bërë kërkesa të tilla ndërkohë që 44% pohuan të kundërtën.



¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: neni 41 dhe 42 i Kushtetutës; Kodi Civil; Ligji nr.7501/1991 “Për token”;

Ligji nr.9325/2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”; Ligji nr.8561/1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.


Figura 9. A keni informacion lidhur me procedurat e shpronësimit, kthimit dhe kompensimit të pronës, si dhe të drejtat tuaja?



30.6% e të anketuarëve pohuan se kanë informacion lidhur me këto procedura, ndjekur nga 25.5% e të anketuarve që kanë njohuri të pjesshme. Rreth 11.8% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë dijeni, ndjekur nga 13.65% e tyre që pohojnë mungesë interesi rreth informacionit lidhur me të drejtat e tyre pronësore.

Figura 9.1. Nëse institucionet ju kanë sqaruar për procedurat dhe kushtet e shpronësimit për interes publik, kthimit apo kompensimit të pronës, a ka qenë i qartë ky informacion?

Pjesa më e madhe e të intervistuarëve (28%) janë shprehur se nuk janë interesuar, në mënyrë kontadiktore me 13.65% të të anketuarve që janë shprehur se nuk kanë interes. 25,1% të të anketuarve pohuan se informacioni ka qenë pjesërisht i qartë, ndjekur nga rreth 1 në 4 të intervistuar (19.6%) të cilët shprehen se informacioni ka qenë i paqartë ndërsa vërehet edhe një trend rreth mungesës së informacionit të ofruar nga institucionet përkatëse pohuar nga 5% e të intervistuarve.



Shumica e qytetarëve (60.5%) pohuan se nuk e kanë ushtruar të drejtën e ankimit në rastet e shpronësimit, kthimit apo kompensimit të pronës, duke treguar të njëjtin trend sa i takon mungesës së besueshmërisë në institucione, kundrejt 39.5% të të anketuarve të cilët pohuan se e kanë ushtruar këtë të drejtë. Nga të anketuarit të cilët pohuan ushtrimin e të drejtës së ankimit, shumica prej tyre (44,5%) kanë pohuar se institucionet shtetërore përgjegjëse nuk u janë përgjigjur në kohë brenda afateve ndjekur nga 38.5% të të anketuarve të cilët pohuan se kanë marrë përgjigje pjesërisht në afat.




Figura 10. A keni ushtruar të drejtën e ankimimit lidhur me procedurat dhe kushtet e shpronësimit, kthimit apo kompensimit të pronës, në rrugë administrative?




Figura 10. 1. Nëse përgjigjia e pyetjes së mësipërme është po, a ju është përgjigjur në kohë brenda afateve institucioni shtetëror përgjegjës?

Figura 11. Nëse jeni shpronësuar, a ka qënë shpërblimi i drejtë për shpronësimin e pronës tuaj për interes publik?

Pjesa më e madhe e të anketuarve, 52% e tyre pohuan se shpërblimi për shpronësimin e pronës nuk ka qënë i drejtë ndjekur nga 33%, të cilët mendojnë se janë shpërblyer pjesërisht në mënyrë të drejtë. Një pjesë e vogël e të anketuarve, vetëm 15% e tyre kanë pohuar se shpërblimi i tyre ka qënë i drejtë.




Figura 12. A jeni ankuar për masën e shpërblimit?

Pavarësisht se pjesa më e madhe e të anketuarve kanë shfaqur pakënaqësi lidhur me masën e shpërblimit të shpronësimit të tyre, gjithashtu pjesa dërmuese e tyre ka pohuar se nuk janë ankuar për masën e shpërblimit (59%).

Nga ana tjetër, për 41% të të anketuarve të cilët kanë pohuar se janë ankuar për shpërblimin që kanë marrë, KShH i pyeti lidhur me rezultatin e ankimimit të tyre.

Një pjesë e të anketuarëve janë ende në proces gjyqësor ku referojnë për procese shumë të gjata (p.sh. 7 apo më tepër vite), ndërsa përmendet disa herë si arsye e ankimimit se prona është zhvlerësuar duke u shpërblyer për kategorinë e gabuar p.sh. si tokë bujqësore ndërkohë që prona





Fig 13. Nëse keni kërkuar kthim apo kompensim të pronës së shtetëzuar apo konfiskuar gjatë regjimit totalitar, a i keni marrë ato?



ka qënë tokë truall. Shumica referojnë gjithashtu se pavarësisht ankimimit, rezultati nuk ka ndryshuar.

Nga 362 të anketuar që pohuan se kanë kërkuar kthim dhe/ose kompensim të pronës, rreth 18% kanë pohuar se e kanë marrë pronën ose kompensimin plotësisht. Rreth 1 në 3 të anketuar (33%) pohojnë se kanë marrë pronën ose kompensimin por pjesërisht, ndërsa për 20% të tjerë çështja vijon të jetë në proces. Pothuajse 1 në 3 persona (29%) e të anketuarve kanë pohuar se u është refuzuar kjo e drejtë.





Figura 14. A vlerësoni se ka qënë i drejtë kompensimi dhe kthimi i pronës?

Vetëm 14% e të anketuarve pohojnë se kompensimi apo kthimi i pronës ka qënë i drejtë, ndërkohë që pjesa tjetër shprehin pakënaqësi lidhur me të. Për 29% të të anketuarve, kompensimi ka qënë pjesërisht i drejtë ndërsa përqindjen më të lartë, 34%, e zënë të anketuarit të cilët nuk janë aspak të kënaqur me kthimin apo kompensimin e pronës. Nga ana tjetër,

23% e të anketuarve shprehen se nuk kanë përfituar ende kompensim apo kthim të pronës së marrë gjatë regjimit të mëparshëm totalitar.

Figura 15. Prej sa kohësh zgjat procesi i kthimit dhe kompensimit të pronës?

Siç evidentohet më sipër, KShH vëren se tejzgjatja e proceseve është një faktor i dëmshëm në rifitimin e të drejtave pronësore të humbura si rrjedhojë e shtetëzimit gjatë regjimit totalitar. Shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e të anketuarve ose 37% e tyre shprehen se ky proces ka zgjatur mbi 30 vite ndjekur nga



22.44% të cilët pohojnë se proceset kanë zgjatur 11-20 apo 21-30 vite. Vetëm 19.9% të të anketuarve pohojnë se ky proces ka përfunduar ndërsa për rreth 31.23% të të anketuarve kohëzgjatja e këtyre proceseve ka qënë më e arsyeshme mes 1-5 apo 6-10 viteve.

Si rrjedhojë e kohëzgjatjes tepër të lartë me natyrë zvarritëse, ankimi gjyqësor nuk është një rrugë e preferuar kur nuk kanë qënë dakord me vendimmarrjet e organeve administrative përgjegjëse. Konkretisht, shumica e të anketuarve ose 55% e tyre kanë pohuar se nuk kanë ndjekur rrugën gjyqësore në rastet kur nuk kanë qënë dakord me vendimet lidhur me pronën e tyre, kundrejt 45% të të anketuarve të cilët kanë pohuar të kundërtën.




Figura 16. A keni ndjekur rrugën gjyqësore kur nuk keni qënë dakord me vendimet për dëmshpërblimin nga shpronësimi apo vendimmarrjet për kthimin dhe kompensimin e pronës?




Figura 16. 1. Nëse përgjigjia e pyetjes së mësipërme është po, a ka qënë në tërësi gjykimi i drejtë dhe i zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm?

Ndërkohë që midis atyre që kanë ndjekur rrugë gjyqësore, pjesa më e madhe (49% e tyre) kanë pohuar se gjykimi nuk ka qënë i drejtë dhe nuk është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm, 16% të të anketuarve pohojnë se kanë patur një proces të arsyeshëm në kohë dhe gjykim të drejtë dhe 35% e të anketuarve vlerësojnë se kanë marrë pjesërisht një gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Figura 17. Cilat janë arsyet që kanë sjellë vonesa dhe padrejtësi në proceset gjyqësore për këto çështje?

Pjesa më e madhe e të anketuarve, 38,3% e tyre pohojnë se korrupsioni është arsyeja kryesore që ndikon në proces ndjekur nga 33,9% e të anketuarve që cilët mendojnë se shkak për vonesat apo padrejtësinë në vendime bëhet edhe mungesa e profesionalizmit nga institucionet në fjalë. Ndër arsye të tjera që lidhen me vonesat dhe padrejtësitë në procesin gjyqësor përfshijnë: ndryshimin e shpeshtë të ligjeve, ngarkesa në gjykata, mungesa e dëshires së mirë nga institucionet përgjegjëse, mungesa e respektimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ndikimi politik etj.





Figura 18. Nëse i jeni drejtuar gjykatës, cila ka qenë kohëzgjata e procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e tij?



Përveç proceseve administrative, proceset gjyqësore gjithashtu njihen për kohëzgjatje të paarsyeshme. Tendencia e tejzgjatjes së procesit gjyqësor mbetet e njëjtë me të dhënat e evidentuara më sipër për proceset e tjera për kthimin dhe kompensimin e pronës. 33,9% e të anketuarve kanë pohuar për mbi dy dekada të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, ndjekur nga 10,4% të cilët pohojnë një zgjatje prej 11-20 vite. Për 14,85% të të anketuarve procesi ka përfunduar kundrejt 10,65% për të cilët procesi ende vijon.

TRANSPARENCA NDAJ QYTETARËVE DHE PJESËMARRJA E TYRE NË PROCESE VENDIMMARRËSE TË LIDHUR ME TË DREJTAT PRONËSORE DHE TË MJEDISIT

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (IQPR) nënvizon në nenin 25 të tij, të drejtën e çdo qytetari për të “marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirishit”. Në Komentin e Përgjithshëm 25 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara parashikohet që mënyrat e pjesëmarrjes së qytetarëve, të cilat përfshijnë debatin dhe dialogun publik, duhet të vendosen nga kushtetuta dhe ligjet e tjera të shtetit në fjalë.¹⁷

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet tona kuadër, mbrojnë të drejtën e informimit, promovojnë proceset e konsultimit publik dhe konsultimit paraprak me qytetarët për vendimmarrje që ndikojnë në jetët e tyre, sikurse janë edhe çështjet e mjedisit dhe të drejtat pronësore. Duke u bazuar në këto të drejta, KShH me anë të mbrojtësve të të drejtave të njeriut realizuan dy monitorime me fokus respektimin e të drejtave të banorëve që u prekën nga shembja e pallatit të tyre si dhe të banorëve në zonën buzë lumit Drin, ku planifikohet të ndërtohet Hec Skavica.

i. Mbi shembjen e pallatit pranë rrugës “Myslym Keta”, në kuadër të procesit të rindërtimit

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH monitoruan ankesat e banorëve të Pallatit nr. 4, Rruga “Myslym Keta”, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Në dt.13.04.2023, vëzhguesit e KShH-së intervistuan në terren një ish banorë të pallatit nr. 4 në rrugën “Myslym Keta”, si dhe kërkuan informacion zyrtar nga ana e Bashkisë Tiranë¹⁸. Në kushtet e mosrespektimit të afatit ligjor për garantimin e të drejtës së informimit nga ky institucion, KShH ushtroi të drejtën e ankimit administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në përfundim të procedurës së ankimit administrativ të realizuar nga Zyra e Komisionerit, u bë e mundur vënia në dispozicion e informacionit nga Bashkia Tiranë. Duke marrë shkas se nga ana e Bashkisë Tiranë u informuam se për shkak të situatës emergjente është zbatuar një legjislacion i posaçëm, i miratuar në kushtet e tërmetit, KShH

¹⁷Shih fq.51-52 të raportit të publikuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në këtë link:

<https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2022/10/Raport-Studimor-Instrumentet-ligjore-dhe-sfidat-e-angazhimit-te-qytetareve-dhe-te-shoqerise-civile-ne-proceset-vendimmarrese-dhe-legjislative-te-kuvendit.pdf>

¹⁸ Në përputhje me kompetencat e saj, sipas ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin Social” dhe VKM-së nr. 361, dt 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”.

vlerësoi t'i drejtojë një kërkesë të re Bashkisë Tiranë, në përgjigje të së cilës u mor sërish informacion i pjesshëm vetëm mbi subvencionimin e qirasë¹⁹.

Informacioni i përcjellë nga Bashkia Tiranë nëpërmjet shkresave të sipërpërmendura, nuk j'u përgjigj kërkesave të KShH-së sa i takon përmbushjes të përgjegjësiqve që i janë njohur Njësive të Qeverisjes Vendore, sipas përcaktimeve të nenit 9 pika "b" e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" dhe pikës 21 të VKM nr. 361, dt 29.05.2019.

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë edhe shqetësimin e banorëve të zonës për cenim të së drejtës së pronësisë e mosgarantimin efektiv të së drejtës së strehimit, në zbatim të nenit 11 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", KShH vërejt i se nuk është respektuar detyrimi për garantimin e parimit të gjithëpërfshirjes nëpërmjet nxitjes së komunitetit për të marrë pjesë në procesin vendimmarrës.

Në përfundim të këtij procesi, KShH i rekomandoi Bashkisë së Tiranës marrjen e masave konkrete për garantimin e transparencës të plotë ndaj banorëve mbi procesin e ndjekur për shembjen e pallatit nr. 4 në lagjen "Myslym Keta" në kuadër të procesit të rindërtimit.

ii. Mungesa e informimit dhe përfshirjes së banorëve në çështjet mjedisore (ndërtimi i digës së kavicës mbi lumi "Drin i Zi")

Në datën 18 dhjetor 2023, Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut pranë KShH-së realizuan një vizitë monitoruese në Qarkun Dibër, lidhur me ndërtimin e Digës së Skavicës, mbi Lumin Drin i Zi. Gjatë takimeve me aktivistë dhe banorë të zonës, KShH u informua se para miratimit nga Kuvendi të ligjit nr. 38/2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International inc.", nuk është zhvilluar asnjë proces informimi apo konsultimi me banorët e zonës, tokat dhe pronat e të cilëve do të preken si rrjedhojë e mbulimit nga baseni i ujit. Pretendimet e banorëve mbartin shkelje të nenit 41 pika 1 të Kushtetutës, ku parashikohet se: "Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor." por edhe nenin 56 të Kushtetutës: "Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij."

Sipas banorëve krijimi i digës do të prekë 8 Njësi Administrative në Bashkinë Dibër²⁰ dhe 2 Njësi Administrative në Bashkinë Bulqizë²¹. Kjo do të sjellë sipas tyre, përmbytjen e 1/3 të tokës bujqësore të Bashkisë Dibër, rreth 32 fshatra dhe 13,000 hektarë, duke zhvendosur kundra dëshirës

¹⁹ Rrregulluar nga Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 dhe Akti Normativ nr. 8, datë 16.12.2019.

²⁰ Nj. Adm Kastriot; Nj. Adm Reç; Nj. Adm Zall Dardhë; Nj. Adm Fushalie; Nj. Adm. Arras; Nj. Adm Muhërr; Nj. Adm. Luzni; Nj. Adm. Tomini; Nj. Adm. Maqellarë.

²¹ Nj. Adm. Gjoricë; Nj. Adm. Shupenzë

më shumë se 12,000 njerëz. Krijimi i digës do të ketë ndikim edhe përtej këtyre të dhënave pasi do të ndikojë edhe aspekte të tjera natyrore dhe humane të lidhura me zonën e mbytur. Kjo situatë sjell shkelje edhe të nenit 59 pika 1 gërma “dh” të Kushtetutës e cila parashikon: *“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: Dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;”*.

Ata u shprehen të frikësuar se edhe në rast dëmshpërblimi, për pronat dhe banesat e tyre, përsëri nuk do të jenë në gjendje të krijojnë mundësi dhe kushte të përshtatshe për të punuar apo jetuar në zonë. Toka e punueshme e cila pritet të përmytet pas ndërtimit të digës, do të pamundësojë qëndrimin e tyre në këtë zonë, sepse nuk do të kenë asnjë mundësi për të ushtruar profesionin e tyre, të lidhur me tokën. Në këto kushte banorët shprehen se do të jenë të detyruar të braktisin zonën. Kjo situatë sjell shkelje të nenit 49 të Kushtetutës: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë.”*

Të dhënat e këtij monitorimi, u bënë pjesë e procesit të gjyqimit në Gjykatën Kushtetuese, për kundërshtimin e ligjit për ndërtimin e HEC Skavicës, proces i vendosur në lëvizje dhe përfaqësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe një grup organizatash që kanë në fokus të drejtat e njeriut dhe të drejtat e banorëve të komunitetit që preket nga ky investim. Për herë të parë në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese krijoi një standart pozitiv në çështjet me natyrë mjedisore, duke konstatuar shkelje të së drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, si rrjedhojë e procedurave miratimit të ligjit nr. 38/2021. Kjo gjykatë urdhëroi autoritetet publike për të riparuar shkeljen e konstatuar dhe për të garantuar të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të ligjit nr. 38/2021. Gjithashtu, i kujtoi autoriteteve detyrimin për marrjen parasysh në vijim të rezultateve të procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, për aq sa është e mundur, në zbatim të nenit 8 të Konventës së Aarhusit.²²

IMPAKTI I NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE TE QYTETARËT E BASHKISË GRAMSH

MDNJ-të pranë KShH-së kryen një monitorim në bashkinë Gramsh gjatë muajit dhjetor 2023 me qëllim verifikimin e zbatimit të së drejtës për qasje në ujë të pijshëm dhe të të drejtave të pronësisë së banorëve të Njesisë Administrative Kukur në këtë bashki, si rrjedhojë e ndërtimit të hidrocentraleve në zonë, si dhe verifikimin e përfshirjes së banorëve të prekur në konsultimet mbi këtë procedurë.

²² Vendimi nr.3, dt.30.01.2024.

MDNJ-të konstatuan se shqetësimi thelbësor i banorëve lidhet me tharjen e mundshme të lumit Gribë, pasi nuk do të kenë qasje në ujë të pijshëm, për t'u larë, për vaditje të mbjellave, si dhe për bagëtinë. Këtë shqetësim ata e kanë shprehur duke drejtuar vazhdimisht peticione dhe ankesa pranë organeve përgjegjëse.

MDNJ-të gjithashtu konstatuan se banorët kanë marrë pjesë në 4 dëgjesa publike për miratimin e projektligjit sa i takon vlerësimin të ndikimit në mjedis, kryesisht të organizuara nga subjekti i licencuar, ku pretendohet nga banorët se këto dëgjesa kanë qenë formale dhe nuk u ka ofruar informacionin e nevojshëm lidhur me projektin.

KShH dëshiron të nënvizojë se, sipas Konventës së Aarhusit, shtetet anëtare, përfshi shtetin shqiptar kanë detyrimin të garantojnë, në një periudhë të përshtatshme, pjesëmarrjen efektive të publikut gjatë përgatitjes prej autoriteteve publike të rregulloreve ekzekutive dhe rregullave të tjera ligjore të përgjithshme e detyruese, të cilat mund të kenë një efekt të rëndësishëm në mjedis. Për këtë qëllim, ajo kërkon që pjesëmarrja e publikut të realizohet që në fazat e para të përgatitjes së këtyre rregulloreve dhe/ose instrumenteve të përgjithshme ligjore e normative, përmes ndërmarrjes së disa hapave si: përcaktimi i afateve kohore të mjaftueshme për pjesëmarrje efektive; publikimi ose bërja të disponueshme për publikun e projekteve dhe rregullave ligjore; dhënia e mundësisë publikut për të komentuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve përfaqësuese këshillimore; marrja parasysh e rezultateve të pjesëmarrjes publike, për aq sa të jetë e mundur (neni 8).²³ Në jurisprudencën e tij në lidhje me zbatimin e Konventës së Aarhusit, Komiteti i Pajtueshmërisë ka theksuar se shteti shqiptar duhet të ofrojë mundësi të përshtatshme për pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës, si dhe të miratojë një kuadër të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm ligjor për zbatimin e dispozitave të Konventës (shih vendimin e Komitetit të Pajtueshmërisë AÇC/C/2005/12).²⁴

NDIKIMI I AKSIT RRUGOR THUMANË-KASHAR NË TË DREJTAT PRONËSORE TË BANORËVE TË BASHKISË BËRXULL

Në muajin shkurt 2024, MDNJ-të pranë KShH-së realizuan një monitorim në njësinë administrative Bërxull, me qëllim verifikimin e shqetësimeve nga banorët e kësaj zone, në lidhje me të drejtat e pronësisë së tyre, që janë prekur nga projekti për ndërtimin e aksit rrugor Thumanë-Kashar. Shqetësimi i banorëve lidhet thelbësisht me cenimin e të drejtës së tyre për gëzimin lirisht

²³ Vendim nr. 3 datë 30.01.2024 (V-3/24), Gjykata Kushtetuese e RSH, fq.32

²⁴ Po aty, fq.33.

dhe paqësisht të pronës, si një e drejtë e mbrojtur nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

MDNJ-të konstatuan se disa prej banorëve të cilët preken nga projekti i aksit rrugor Thumanë-Kashar, kanë aplikuar për legalizimin e objekteve të tyre, tip shtëpi banimi, pranë ALUIZNI-t që prej vitit 2006. Megjithatë, ata kanë marrë një përgjigje nga ky i fundit vetëm në tetor të vitit 2023 për përjashtimin nga legalizimi të ndërtimit pa leje. Gjatë muajit dhjetor të vitit 2023, banorët janë njoftuar nga shoqëria ndërtuese e aksit rrugor, për vendimin e skualifikimit dhe përfitimin e bonusit të qerasë, megjithatë banorët pohojnë për problematika lidhur me lëvrimin e bonusit të qerasë nga ana e bashkisë Vorë.



KShH i rekomandon institucioneve përgjegjëse zbatimin e afateve ligjore për njoftimin e banorëve të njësisë administrative Bërxull lidhur me prishjen e banesave të tyre si dhe bashkisë Vorë për ndërmarrjen e masave të nevojshme për miratimin e bonusit të qerasë për banorët e prekur nga ndërtimi i aksit rrugor Thumanë-Kashar.

IV. PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE KONSULTIMI PUBLIK

Informacion i përgjithshëm për të anketuarit

Në anketim u përfshinë 729 individë nga të cilët 50% i përkasin gjinisë mashkullore dhe 49.4% gjinisë femërore, ndërkohë 0.4% e të anketuarve preferojnë të mos e japin këtë informacion.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve **Figura 2.** Përfaqësimi i të anketuarve sipas moshës



Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 35-45 vjeç (25.1%); 26-35 vjeç (23.6%) dhe 18-25 vjeç (20.3%) të cilat përbëjnë pothuajse 69% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë kategorinë më pak të përfaqësuar në anketim me vetëm 4.2% të individëve të anketuar.

Sa i takon nivelit arsimor të të anketuarve, vërehet një pjesëmarrje dominante e të diplomuarve me arsim të lartë e më tej me 38.6%, ndjekur nga 28.7% që kanë nivel arsimor të mesëm. Të anketuarit me arsim profesional përfaqësohen në masën 18% të numrit total të pjesëmarrësve ndjekur nga personat me arsim të mesëm të ulët (8%).

Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas Nivelit arsimor





Figura 4. Përfaqësimi i punësimit të anketuarve

Sa i takon punësimit të të anketuarve, sipas të dhënave në figurën 4, pjesa më e madhe e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat (33.3%), ndjekur nga të vetëpunësuarit me 21.8% dhe më tej afërsisht në të njëjtën masë, të punësuarit në një institucion shtetëror (21.4%). Me statusin e papunë përfaqësohen 15.8% e numrit total të të anketuarve. Studentët përbëjnë një përqindje minimale të të anketuarve (7.7%).

Qarku Tiranë ka përqindjen më të lartë të të anketuarve (20.5%), ndjekur nga qarqet më të mëdha në vend përkatësisht në Durrës (14.7%), Elbasan (13%), Kukës (12.3%) dhe Shkodër (11%). Pjesa më e vogël e të anketuarve është e përqendruar në Berat (2.2% e të anketuarve).





Figura 6. Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut

Gjetjet Kryesore: Pjesëmarrja në jetën publike dhe konsultimi publik

Pyetësi synoi të masë nivelin e respektimit të të drejtës së qytetarëve për pjesëmarrje në procese vendimmarrëse dhe legjislative, të drejtën e ushtrimit të votës, duke ndjekur standarte hulumtuese (pyetje) konform legjislacionit në fuqi.²⁵




Shumica e të pyeturve, rreth 86% e tyre pohojnë se kanë marrë pjesë gjatë votimeve në zgjedhjet vendore të vitit 2023.

Figura 7. A keni marrë pjesë në procesin e votimit në zgjedhjet vendore të këtij viti?

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: neni 45, 81 i Kushtetutës së RSh; Kodi Zgjedhor; Ligji nr. 54/2019, datë 18.7.2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në RSh”; Ligji 146/2014 “Për konsultimet publike”; Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

Figura 8. A kishit informacion paraprak për qendrën tuaj të votimit përpara ditës së votimeve, 14 maj 2023?



Një shumicë e konsiderueshme prej 80% e të anketuarve pohuan se kanë patur informacion paraprak për qendrën ku ata ishin votues, kundrejt 20% apo 1 në 5 të anketuar të cilët nuk kanë patur informacion. Ky rezultat mund të vijë në rrjedhojë të drejtpërdrejtë të të dhënave të figurës së mësipërme, për pjesëmarrje në procesin e votimit.

Figura 9. A ju është ushtruar presion, në çdo lloj forme, për të votuar në zgjedhje, kundër vullnetit tënd të lirë?

Më shumë se 1 në 5 persona (22.7%) pohon se atyre u është ushtruar presion për të votuar në zgjedhje kundër vullnetit të tyre. Shumicës së të anketuarve nuk u është ushtruar ky presion (77.3% e tyre).





Figura 10. A jeni konsultuar ndonjëherë për çështje ose projektvendime që diskutohen në mbledhjen e këshillit bashkiak?

KShH vlerëson se një matës i rëndësishëm i nivelit të angazhimit të qytetarëve në jetën publike konsiston në angazhimin pranë proceseve vendimmarrëse të Këshillit Bashkiak pranë vendbanimit të tyre. 73% e të anketuarve pohuan se nuk janë konsultuar ndonjëherë për çështje apo projektvendime që diskutohen në mbledhjen e këshillit bashkiak kundrejt 27% të cilët pohuan se janë konsultuar.

Siç rezulton nga figura 11, 20% e të anketuarve në qytetin e Fierit kanë pohuar se janë konsultuar për projektvendime apo çështje në mbledhjet e këshillit bashkiak, ndjekur nga bashkia Kukës ku 19.5% e qytetarëve kanë pohuar të njëjtën gjë. 16% e të anketuarve në bashkinë Tiranë gjithashtu

pohojnë se janë përfshirë në konsultime publike nga ana e bashkisë ndjekur nga 13.4% e qytetarëve të Vlorës dhe 1 në 10 qytetarë (10%) në bashkinë Shkodër që pohojnë se kjo bashki është konsultuar me qytetarët për projektvendime në këshillin Bashkiak.

Bashkitë më problematike sa i takon perceptimit të qytetarëve lidhur me përfshirjen e tyre në konsultimin publik janë bashkia Tiranë – ku 20.3% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë marrë në konsultime publike; bashkia Durrës – 19.5% e të anketuarve dhe bashkia Elbasan ku 14.4% e të anketuarve mohojnë të jenë përfshirë në konsultime publike.




Figura 11. Konsultimet e projektvendimeve në këshillin bashkiak sipas bashkive.

66% e të anketuarve pohuan se nuk kanë informacion sa i takon mundësisë për konsultim publik me qytetarët e projektbuxhetit të bashkisë ku banojnë. Vetëm 34% e qytetarëve të anketuar pohuan se janë të informuar mbi konsultimin e projektbuxhetit në bashkinë e tyre.





Figura 12. A jeni i informuar për mundësinë e konsultimit publik me qytetarët të projektbuxhetit në bashkinë ku ju banoni?

I njëjti trend me sa më lart vihet re edhe kur të anketuarit janë pyetur lidhur me informimin për mundësinë e konsultimit publik të projektbuxhetit të bashkisë ku banojnë. Qytetarët në Tiranë (24%), Durrës (19%) dhe Elbasan (15.5%) mohojnë të kenë informacion lidhur me mundësinë e konsultimit publik të projektbuxhetit në këto Bashki. Nga ana tjetër, qytetarët në bashkinë Kukës (19.5%), Fier (17.5%) dhe Vlorë (16%), pohojnë se janë të informuar lidhur me mundësinë për tu përfshirë në konsultimin publik të projektbuxheteve të secilës prej këtyre bashkive.

Figura 13. Informimi për mundësinë e konsultimit publik të projektbuxhetit sipas bashkisë ku të anketuarit banojnë?



Pjesa më e madhe e të anketuarve ose 44% e tyre mendojnë se projekt buxheti i bashkisë nuk i nënshtrohet realisht konsultimit publik, ndjekur nga 35% e tyre të cilët pohojnë se nuk e dinë nëse ky konsultim kryhet realisht. Vetëm rreth 1 në 5 persona (ose 21%) prej të anketuarve pohojnë kryerjen e konsultimit.




Figura 14. A mendoni se konsultimi publik me qytetarët që realizohet nga bashkitë ka vërtet si qëllim të marrë në konsideratë mendimet dhe sugjerimet e tyre?

Është shqetësues fakti se 40% e të anketuarve pohuan se ky proces nuk realizohet me qëllim për të marrë mendimet e vërteta të qytetarëve ndjekur nga 26.5% të cilët nuk kanë dijeni nëse konsultimi ka këtë qëllim ose jo. Vetëm 17,5% e të anketuarve pohojnë se konsultimi është i vërtetë.

Figura 15. A keni dijeni se cilat janë detyrimet që duhen paguar për taksat vendore?

Shumica e të anketuarve, përfaqësuar nga 66% e tyre pohojnë se kanë dijeni për detyrimet që duhen paguar për taksat vendore (44.9%) ose kanë pjesërisht dijeni (21.2%) lidhur me detyrimet që ata duhet të paguajnë. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme, 33.9% e të anketuarve pohuan se nuk janë dijeni rreth këtyre taksave.





Figura 16. A mendoni se taksat vendore janë të përballueshme me të ardhurat tuaja familjare?



KShH vëren se 33% e të anketuarve mendojnë se taksat vendore janë pjesërisht të përballueshme në krahasim me të ardhurat familjare, ndjekur nga 29% të cilët pohojnë se këto taksa mund të përballohen. Për 22% të të anketuarve, taksat vendore rezultojnë të mos jenë të përballueshme krahasuar me të ardhurat mujore, ndjekur nga 19% e tyre që nuk e dinë përgjigjen e pyetjes.

LIRIA E TUBIMEVE

Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to, garantohet në nenin 47, pika 1, të Kushtetutës. Ushtrimi i kësaj lirie nuk i nënshtrohet asnjë procedure formale miratimi nga organet e policisë, por sipas ligjit nr. 8773/2001 “Për tubimet” kërkohet vetëm kryerja e njoftimit në organet e policisë në një kohë të përcaktuar. Fakti që në ligjin nr. 8773/2001 përdoret termi “njoftim” dhe jo “kërkesë”, drejtuar organeve të policisë për zhvillimin e tubimit është me rëndësi, pasi garanton ushtrimin e së drejtës së tubimit nga ana e shtetasve.

Autoritetet shtetërore kanë detyrimin pozitiv për të lehtësuar dhe mbrojtur ushtrimin e kësaj të drejte, me përjashtim të rasteve kur legjitimohet ndërhyrja për të kufizuar, në përputhje me nenin 11/2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe sipas parashikimeve të legjislacionit vendas (nr.8773/2001).

Për sa jemi vënë në dijeni në korrespondencën tonë zyrtare, sa i takon tubimeve dhe protestave të njoftuara/zhvilluara gjatë periudhës 2020-2024, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit pohoi për KShH se strukturat e saj janë njoftuar në total për zhvillimin e 242 tubimeve nga persona, grupe informale dhe OJF të ndryshme. Tubime urgjente për këtë periudhë ka pasur gjithsej 85 raste. Tubimet e lejuara dhe kërkesat e pranuar nga Policia e Shtetit për zhvillimin e tubimeve ka qenë 495. KShH vlerëson se përdorimi i terminologjisë "lejim" ose "pranim" është i gabuar pasi sikurse e kemi nënvizuar më herët, sipas ligjit organizatorët nuk marrin leje, ata vetëm njoftojnë. Gjithashtu, këto të dhëna janë kontradiktore pasi teksa përmenden 242 tubime të njoftuara dhe tubime urgjente janë 85, e dhëna e referuar më tej në shkresën e policisë së shtetit se tubimet e pranuar janë 495 nuk korrespondon me ato më herët (shumatoren e kërkesave të pranuar dhe tubimeve urgjente).

Tematikat kryesore për zhvillimin e tubimeve, të cilat janë njoftuar paraprakisht pranë Policisë së Shtetit, gjatë kësaj periudhe rezultojnë se kanë qenë:

- Tubimet/protesta të zhvilluara në përgjithësi kanë qenë të karakterit social-ekonomik dhe të karakterit politik;
- Për rritje të çmimeve;
- Për pagat e prapambetura dhe rifillimin e punës, sidomos në industrinë e naftës dhe fasonerisë;
- Në lidhje me të drejtën e pretenduar të shfrytëzimit të burimeve ujore;
- Në lidhje me sistemin e taksimit nga institucione e qeverisjes vendore;
- Kundër prishjes së Teatrit Kombëtar;
- Kundër vendosjes së rregullave për hyrjen në parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta;
- Në lidhje me vrasjen e 25 vjeçarit, Klodian Rasha, në Tiranë nga punonjësi i policisë;
- Tubime të organizuara nga shërbimet e taksive dhe ai i transportit publik, në lidhje me të drejtat e tyre;

- Për sensibilizimin për të drejtat e komunitetit rom;
- Për të drejtat e fëmijëve;
- Për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje;
- Në lidhje me subvencionimin e fermerëve nga ana e shtetit;
- Për rritjen e pensioneve për minatorët;
- Kundër ndërtimit të H/C Skavicës;
- Për mbrojtjen e mjedisit;
- Për kundërshtim të Vendimit të Qeverisë Shqiptare, për miratimin e marrëveshjes me qeverinë Italiane në lidhje me akomodimin e emigrantëve të huaj në Shëngjin dhe në Gjadër;
- Për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, etj.

Ndërkohë, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, Policia e Shtetit është shprehur se tubimet e njoftuara janë ndaluar të zhvillohen nga ana e saj. Sikurse dihet, GJEDNJ-ja është shprehur se liria e tubimit nuk është absolute; ajo mund të kufizohet në përputhje me paragrafin 2 të nenit 11 të Konventës. Ndërhyrja mund të mos jetë një ndalim i plotë, ligjor ose de facto, por mund të konsistojë në masa të tjera të ndryshme të marra nga autoritetet. Gjithashtu, një ndërhyrje në lirinë e tubimit paqësor përbën shkelje të nenit 11, përveçse kur është “parashikuar nga ligji”, ndjek një ose më shumë “qëllime legjitime”, sipas paragrafit 2 të nenit 11 dhe është "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për të arritur qëllimin ose synimet në fjalë.

KShH vlerëson se, ndalimi i të drejtës së tubimit gjatë pandemisë CoVid-19 ka vendosur një kufizim joproporcional të lirisë së tubimit dhe bashkë me të edhe të lirisë së shprehjes në mënyrë kolektive. Më datë 13 maj 2020, nëpërmjet deklaratës së tij për shtyp, KShH ka sugjeruar rishikimin e formulimit në aktin normativ nr. 3 të datës 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”. Në këtë deklaratë, KShH vëren se bazuar dhe në praktikat e vendeve të tjera demokratike të Evropës, ku janë lejuar tubimet që respektojnë distancimin fizik dhe me masa mbrojtëse (p.sh. distancimi fizik i protestuesve, përdorimi i mjeteve mbrojtëse të tyre, etj.), sanksionet në legjislacionin shqiptar tkurrin në mënyrë jo proporcionale të drejtat dhe liritë themelore, një prej të cilave është liria e tubimit dhe organizimit. Nga monitorimet e realizuara nga KShH, përgjatë kësaj periudhe është vënë re se praktikat e ndjekura nga ana e Drejtorive Vendore të Policisë nuk kanë qënë të unifikuara në raport me lejimin e ushtrimit të të drejtës së tubimit gjatë periudhës së pandemisë. Në disa raste janë marrë masa administrative ndaj qytetarëve, ndërkohë që ka patur Komisariate që kanë ndjekur një linjë më të ashpër, duke kallëzuar protestuesit në prokurori.²⁶

²⁶ <https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2022/09/PERFUNDIMTARE-BAROMETRI-KOMBETAR-2-.pdf>

Policia e Shtetit ka informuar KShH-në se nuk ka sanksionuar asnjë shtetas në bazë të kundërvajtjeve penale të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 8773/2001, por ka kryer vetëm referime të veprave penale pranë prokurorisë përkatëse. Veprat penale që i janë referuar prokurorisë kanë qenë kryesisht ‘Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme’ dhe ‘Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit’, parashikuar në nenet 262 dhe 293 të Kodit Penal.

Shqetësues është fakti se organet ligjzbatuese dhe ato të drejtësisë, vijojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre për procedimet dhe gjykimet penale lidhur me tubimet e paligjshme, bazuar në nenin 262 të Kodit Penal që është gjetur me mangësi nga Gjykata Kushtetuese. Konkretisht, me vendimin nr. 24, datë 04.5.2021, kjo Gjykatë konstaton se neni 262, paragrafi i parë, i KP-së përdor shprehjen “pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta”, për zhvillimin e tubimeve në sheshe ose vendkalime publike, ndërkohë që ligji nr. 8773/2001 për këto lloj tubimesh përcakton se duhet njoftimi me shkrim i Policisë së Shtetit. Këto dy terma nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën në atë masë që krijojnë pasiguri dhe paqartësi, duke shkaktuar cenimin e parimit të sigurisë juridike nga dispozita objekt shqyrtimi, çka krijon vështirësi në njohjen, kuptimin dhe zbatimin e kësaj norme penale nga individët dhe organet ligjzbatuese.

Edhe pse kanë kaluar 3 vjet nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese (Maj 2021), ndërkohë që organizatat e shoqërisë civile i janë drejtuar me një petition Kuvendit, në gusht të vitit 2022, për plotësimin e vakumit ligjor dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e kësaj dispozite, pas dhënies së vendimit të GJ.K, ende nuk ka patur një reagim prej këtij institucioni. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mbetet i pazbatuar, duke krijuar një mjedis ligjor tkurrës sa i takon ushtrimit të lirisë së tubimit.

KShH vlerëson se mungesa e një norme të formuluar në mënyrë të qartë e të plotë, konform vendimit të detyrueshëm të GjK, krijon pasiguri juridike tek qytetarët si dhe krijon premisa për cenimin e lirisë së tubimit, për shkak të mënyrës se si kjo dispozitë e paplotë mund të zbatohet nga organet përgjegjëse për kallëzimin, fillimin e procedimit penal, hetimin apo gjykimin e çështjeve penale të lidhura me akuzat penale për organizimin dhe pjesëmarrjen në grumbullime e manifestime të paligjshme. Rrjedhimisht, shtetasit që marrin pjesë në tubime të cilat policia e shtetit i referon si të paligjshme, ekziston rreziku për cenimin e garancive procedurale që ata duhet të kenë në ushtrimin e kësaj të drejte, sipas nenit 11/2 të KEDNJ-së.

PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE USHTRIMI I DREJTËPËRDREJTË I SOVRANITETIT TË POPULLIT

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH-së realizuan një vëzhgim të pjesshëm të kuadrit ligjor mbi referendumet dhe zbatimin e tij në praktikë, duke u bazuar në korrespondencën me

shkresa zyrtare, me institucionet publike përgjegjëse për administrimin e kërkesave për referendum, zhvillimin dhe ndjekjen e mbarëvajtjes së tyre. Qëllimi i këtij vëzhgimi ishte të evidentoheshin dhe analizoheshin shkaqet e mospërdorimit të instrumentit të referendumit nga zgjedhësit dhe rastet jo të suksesshme të tij.

Referendumi si instrument i ushtrimit të sovranitetit të drejtëpërdrejtë nga populli (demokracisë direkte) gjen rregullim në mënyrë të përgjithshme në tre akte juridike, duke përfshirë këtu Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dispozitat për Referendumin në Ligjin Nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Në Shqipëri akoma nuk ka një ligj të miratuar për rregullimin e plotë dhe në mënyrë të detajuar të mekanizmit të referendumeve. Për pasojë edhe ato pak dispozita të cilat janë në fuqi nuk parashikojnë në mënyrë të plotë dhe koherente, rregullat për ushtrimin e tij.

Aktoret e shoqërisë civile kanë ndeshur vështirësi në organizimin e referendumeve në nivel vendor për çështje që kanë patur ndjeshmëri apo interes të lartë publik (ngritja e impiantit të petroliferes në Vlorë etj). Me shqetësim vihet re se çdo iniciativë e ndërmarrë për referendum vendor ka dështuar në vendin tonë. Përgjatë 34 viteve të demokracisë, Shqipëria nuk ka zhvilluar asnjë referendum vendor²⁷.

Sa i takon plotësimit të kuadrit ligjor në këtë drejtim, ka patur iniciativa në vitin 2020 dhe 2022 nga deputetë të Kuvendit, ku janë propozuar dy projektligje për referendumin. Projektligji i dytë është në proces. Këto projektligje kanë sjellë risi në rregullimin e mbajtjes së referendumeve sidomos sa i takon barrës financiare të realizimit të referendumeve, e cila duhet të jetë pjesë e buxhetit të shtetit, si dhe përfaqësimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit nëpërmjet parashikimeve për nënshkrimin elektronik, si një mjet që garanton një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse duke iu njohur të drejtën e pjesëmarrjes në referendum.

Të dhëna për historikun e referendumeve në Shqipëri

Tabela më poshtë jep të dhëna mbi referendumat e realizuara në Shqipëri që prej vitit 1997 deri në vitin 2023. Sikurse vërehet, populli shqiptar ka patur mundësinë të shprehë tërësisht dhe lirisht vullnetin e tij, duke konkluduar me sukses vetëm 2 referendume, përkatësisht për çështjen e shtruar lidhur me formën e qeverisjes në vitin 1997 dhe miratimin e Kushtetutës në vitin 1998.

²⁷Që kur Shqipëria miratoi fillimisht ligjin nr.7491, dt.29.4.1991 “Për dispozitat kryesore Kushtetuese” që parashikoi të drejtën e referendumit dhe më pas Kushtetutën e vitit 1998 që parashikon një rregullim më të mirë kushtetutes të këtij instrumenti, si vihet në lëvizje dhe cilat janë format e tij.

Nr.	Data	Objekti i referendumit	Perfundimi
1	29.06.1997	Referendum i përgjithshëm për formën qeverisëse ku ishin dy alterantivat, “Republikë Parlamentare” apo “Monarki Kushtetuese”,	Zgjidhet "Republikë Parlamentare"
2	28.11.1998	Referendum për miratimin e Kushtetutës së re.	Miratim i Kushtetutës së Re
3	23.10.2003	Referendum kushtetutes për shfuqizimin e neneve 4 dhe 6 të ligjit “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.	Referendumi konsiderohet si antikushtetues (në kundërshtim me nenin 151 të Kushtetutës)
4	29.05.2008	Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve paraqitet kërkesa e një grupi nismëtar prej 24 zgjedhësish për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e neneve 5, 7 dhe 8 të ligjit nr.9904 “Për disa ndryshime në Kushtetutën e RSH”.	Referendumi konsiderohet si antikushtetues
5	14.11.2013	Partia Demokratike, me anë të 28 deputetëve të saj depoziton në Kuvend kërkesë për mbajtjen e një referendumi të përgjithshëm për ndalimin e mbetjeve.	Kërkesa rrëzohet.
6	31.10.2014	Banorët e 82 Komunave dhe Bashkive i drejtohen KQZ-së duke u shprehur se janë kundër ndryshimeve të reja territoriale ndaj kërkuar që të mbahet një “Referendum vendor”.	Kërkesa rrëzohet.
7	29.09.2016	Partia Demokratike me anë të një kërkesë të firmosuar nga më shumë se 1/5 e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, i drejtohet kësaj të fundit me kërkesën e për zhvillimin e një referendumi të përgjithshëm me objekt “Importimin, Transportimin dhe vendsojen në Republikën e Shqipërisë të armëve kimike dhe të lëndëve të tjera helmuese ushtarake”.	Kërkesa nuk miratohet nga Kuvendi, por pas shumë protestave të Shoqërisë Civile importimi i armëve u ndalua.
8	04.03.2016	Partia Demokratike i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kërkesë për mbajtjen e një “Referendumi vendor” për 3 projektet e Bashkisë Tiranë. Projektet në fjalë ishin: Parku i lojrave tek Liqeni Artificial, Parkimi nëntokësor tek Tajvani, dhe rruga automobilistike tek Pallati i Koncerteve.	Kërkesa rrëzohet.
9	02.06.2020	Shoqëria Civile i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndryshime në Kodin Zgjedhor.	KQZ-ja e rrëzon këtë kërkesë duke u justifikuar se nuk plotësohet dot kuorumi.
10	29.06.2023	Partitë e vogla opozitare me nismëtarin kryesore, partia “Nisma Thurje” të cilat kërkuar ndryshime në Kodin Zgjedhor me argumentimin se ky Kod, favorizon 3 partitë kryesore “PD-PS-PL”.	Kërkesa rrëzohet.

V. AKSESI NË DREJTËSI

Informacion i përgjithshëm për të anketuarit

Në anketim u përfshinë 612 individë nga të cilët 51.8% i përkasin gjinisë mashkullore dhe 47.9% gjinisë femërore.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve





Figura 2. Përfaqësimi i anketuarve sipas moshës



Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 35-45 vjeç (26%); 26-35 vjeç (21%) dhe 18-25 vjeç (19%) të cilat përbëjnë pothuajse 66% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë kategorinë më pak të përfaqësuar në anketim me vetëm 7% të individëve të anketuar.

Sa i takon nivelit arsimor të të anketuarve për këtë të drejtë, shumica janë me arsim të lartë e më tej me 37.4%, ndjekur nga 29.6% që kanë nivel arsimor të mesëm dhe një përfaqësim pothuajse të barabartë të personave me arsim profesional (13.2%). Kategoritë më pak të përfaqësuar në anketë mbeten të anketuarit me arsim fillor (18.8%) ose me doktoraturë (7%).

Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas Nivelit arsimor






Figura 4. Punësimi i të anketuarve

Pjesa më e madhe e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat (31%), ndjekur nga një pjesëmarrje pothuajse e barabartë midis të punësuarve në një institucion shtetëror (21%) dhe të vetëpunësuarve 21% dhe të papunëve (20%). Studentët përbëjnë 7% të të anketuarve.

Qarku Tiranë ka përqindjen më të lartë të të anketuarve (21%) ndjekur nga qarqet më të mëdha në vend Durrës (14%), Elbasan (13%), Shkodër (13%) dhe Vlorë (13%). Pjesa më e vogël e të anketuarve është e përqendruar në Berat (1% e të anketuarve).


Figura 6. Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut



Gjetjet Kryesore: Aksesi në drejtësi

Të dhënat e kësaj pjese të sondazhit synojnë të hedhin dritë mbi sfidat dhe nevojat që kanë grupet e marginalizuara në qasjen e tyre në drejtësi në Shqipëri. Pyetjet drejtuar të anketuarve që përbëjnë standartet hulumtuese janë bazuar në legjislacionin në fuqi²⁸.

Figura 7. A identifikoheni si pjesëtar i një grupi të marginalizuar?



24.4% e të anketuarve pohuan se i përkisnin grupeve në nevojë. Por kjo e dhënë mund të mos reflektojë panoramën reale, duke marrë në konsideratë se të anketuarit mund të mos pohojnë identifikimin me një grup të caktuar për arsye të ndryshme (p.sh. diskriminimi, Fig 7).

Të anketuarit gjithashtu u pyetën nëse kishin patur mosmarrëveshje ligjore për të cilat i janë drejtuar gjykatës, të cilën e pohuan 1 në 3 persona (ose 36% e të anketuarve)(Fig 8).





Figura 8. A keni patur mosmarrëveshje ligjore për zgjidhjen e së cilës duhet t'i drejtoheshit rrugës gjyqësore?

Figura 8.1. Nëse po, a ka ndodhur që të mos e ndiqnit rrugën gjyqësore për shkak të pamundësisë financiare për të paguar tarifën gjyqësore dhe/ose për të marrë një avokat/përfaqësues ligjor?



KShH vëren se shumica e të anketuarve, 75,3% e tyre pohuan se pamundësia financiare nuk ka qënë arsye për të mos ndjekur çështjen e tyre në rrugë gjyqësore. Megjithatë 1 në 4 persona, referojnë se ka patur raste ku për shkak të pamundësisë financiare për të paguar tarifën gjyqësore apo për të marrë një avokat nuk kanë kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre nëpërmjet gjykatës.

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti.

Figura 9. A keni dijeni për mundësinë e ndihmës ligjore falas nga shteti në kushtet kur nuk keni mundësi financiare për të bërë padi në gjykatë?

Kur u pyetën nëse ishin të informuar për ndihmën juridike të ofruar falas nga shteti, shumica e të intervistuarëve pohojnë se janë të informuar (37,7%) ose pjesërisht të informuar (21,7%), ndërsa 40,6% e të anketuarve mohojnë të kenë dijeni për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Këto të dhëna janë tregues i nevojës për rritur ndërgjegjësimin për të siguruar akses më të mirë të qytetarëve në ndihmën ligjore të ofruar nga shteti në rast pamundësie financiare.





Figura 10. A keni qenë përfitues të ndihmës ligjore falas nga shteti në ndonjë proces gjyqësor?



Nga të dhënat, rezulton se 14% e të anketuarve kanë përfituar ndihmë ligjore falas, ndërkohë që shumica e tyre pohoi se nuk kanë patur procese gjyqësore (34%), ndjekur nga të anketuarit që pohuan se nuk e kanë përfituar atë (29%) dhe ata që nuk kanë patur nevojë për ndihmë juridike (23%).

Marrja e ndihmës ligjore nga një pjesë e vogël e qytetarëve mund të tregojë për nivelin e ulët të informimit të qytetarëve për këtë lehtësi, ose mungesën e besimit të tyre ndaj një shërbimi të tillë të ofruar nga shteti. Kjo vërehet edhe në figurën në vijim.





Figura 10.1. Nëse po, a ka qenë ajo (ndihma juridike e garantuar nga shteti) profesionale dhe efektive në mbrojtjen e çështjes tuaj ligjore përpara gjykatës?

Pakica prej 14% e të anketuarve që pohojnë se kanë përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, rezulton se në 57% të rasteve, kjo ndihmë nuk ka qenë profesionale dhe efektive, kundrejt vetëm 24% të rasteve që vlerësohet me nota pozitive, dhe në 19% të rasteve pjesërisht pozitive (profesionale e efektive).

Figura 11. A keni dijeni për organizatat joqeveritare që ofrojnë ndihmë ligjore falas për individë/kategori në nevojë dhe grupe të marginalizuara?



Tendenca rreth informimit për ndihmën ligjore të ofruar nga OJQ-të mbetet e njejtë me informimin për ndihmën e ofruar nga shteti, pasi nga të dhënat rezultojnë se afro më pak se gjysma e të anketuarve (47,6%) nuk kanë dijeni për OJQ-të tek të cilat mund të kërkojnë shërbime ligjore falas, kundrejt rreth 52,4% të cilët pohuan se kanë plotësisht ose pjesërisht dijeni sa i takon këtyre shërbimeve.

Vendimi për reformimin e hartës së re gjyqësore solli riorganizimin e ri të saj duke ndikuar në shkrirjen e 18 gjykatave, duke lënë funksionale 16 të tjera. Miratimi i kësaj harte ngriti shqëtësime në komunitetin e avokatëve e mbrojtësve ligjore, si dhe organizatave të të drejtave të njeriut sa i takon sigurimit të aksesit në drejtësi për qytetarët, e veçanërisht të grupeve në nevojë.

Figura 12. A është shkrirë ndonjë prej gjykatave që dikur ka qenë në qytetin tuaj (apo në një qytet të afërt me të tuajin), në kuadër të hartës së re gjyqësore?

Rreth 32% e të anketuarve pohuan se gjykata në qytetin e tyre është shkrirë, kundrejt 38% të cilët mohuan një gjë të tillë. Vihet re gjithsesi se qytetarët nuk janë të mirëinformuar rreth hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore pasi rreth 1 në 3 persona pohojnë se nuk kanë dijeni për shkrirjen e ndonjë prej gjykatave pranë vendbanimit të tyre.





Figura 12. 1. Nëse përgjigjia e pyetjes së mësipërme (për shkrirjen e gjykatës) është po, a ju pengon largësia e vendndodhjes së gjykatës së re për të hapur një proces gjyqësor?



Rezultoni se për pjesën më të madhe të të anketuarve, rreth 39.4%, largësia do t'i pengonte plotësisht ose pjesërisht në hapjen e një procesi gjyqësor, ndjekur nga 36% e tyre që e mohojnë këtë pengesë.

KShH pyeti të anketuarit nëse kanë patur rastin për të lexuar një vendim gjyqësor për çështje ku kanë qënë palë apo çështje të tjera. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve pohuan se kanë lexuar vendime gjyqësore (44.3%), kundrejt 55.7% të tyre të cilët mohuan të kenë lexuar një vendim gjyqësor. Për pjesën më të madhe të personave që kanë lexuar një vendim gjyqësor, rezultoni se vendimet janë pjesërisht (38%) ose aspak të qarta dhe të thjeshta (39%) për t'u kuptuar pa ndihmën e një juristi. Vetëm 23% e të anketuarve pohuan se vendimet që kanë lexuar kanë qënë të kuptueshme për ta.




Figura 13. A ju ka rastisur të lexoni ndonjë vendim gjyqësor (p.sh. për çështjen ku ju keni qënë palë ose ndonjë çështje tjetër)?




Figura 13.1. Nëse përgjigjia e pyetjes së mësipërme është po, a janë në përgjithësi vendimet gjyqësore të qarta dhe të kuptueshme për publikun e gjerë, pa nevojën për t'u asistuar nga një

AKSESI NË DREJTËSI I GRUPEVE NË NEVOJË

1. Aksesueshmëria e personave me aftësi të kufizuara në institucionet e drejtësisë dhe organet e sistemit gjyqësor

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH monitoruan institucionet e drejtësisë dhe organet e sistemit gjyqësor, të vendosura në qytetin e Tiranës për të evidentuar nëse godinat e institucioneve ofrojnë kushtet (*reasonable accommodation*) për të qenë lehtësisht të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara në përputhje me parashikimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të ratifikuar nga Shqipëria dhe sipas ligjit shqiptar nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Ky monitorim përfshiu përkatësisht këto institucione: Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë (ILD), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Emërimit në Drejtësi (KED), Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata e Shkallës së Parë, Dhoma Civile, Gjykata e Shkallës së Parë, Dhoma Penale, Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Prokuroria e Posaçme (SPAK), Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Përgjithshme.

Gjatë monitorimit, vëzhguesit e kishin të limituar mundësinë e verifikimit nga afër të standarteve të aksesueshmërisë në godinat e këtyre institucioneve, për shkak të mos-lejimit të aksesit në brendësinë e tyre, si rrjedhojë një pjesë e informacionit iu kërkua me shkresë zyrtare institucioneve.

a. Parkimi i veçantë për personat me aftësi të kufizuara

Një pjesë e madhe e institucioneve nuk ofrojnë parkim të veçantë për personat me aftësi të kufizuara, pasi godinat e tyre janë ndërtuar kohë më parë, dhe si rrjedhojë nuk e kanë planifikimin e duhur për të plotësuar këto kushte. Institucionet që e ofrojnë këtë shërbim janë Gjykata e Lartë, KED, GJKKO, SPAK.

b. Rampa dhe ashensorët për akses më të lehtë për personat me aftësi të kufizuara

Në pjesën më të madhe të institucioneve të monitoruara u vu re ekzistenca e rampës në hyrjen e tyre. Pozitiv është fakti se edhe institucionet e ndërtuara kohë më parë e kanë përshtatur rampën, për të lehtësuar aksesueshmërinë në godinë për personat me aftësi të kufizuara. Ndër institucionet të cilat nuk kanë strukturën e rampës përfshihen Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë dhe Dhoma Penale e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në drejtim të aksesueshmërisë, pozitive është ekzistenca e ashensorëve në shumicën e institucioneve për të kryer lëvizjen nga kati në kat të personave me aftësi të kufizuara. Institucionet të cilat nuk ofrojnë

ashensor janë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata Kushtetuese, ILD dhe Gjykata e Apelit.

c. Dyert dhe tualetet e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar

Çdo institucion në përgjigjet e tyre pohon se madhësia e dyerve hyrëse në institucion ose në sallat gjyqësore është e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje, të cilët përdorin karrocë me rrota për të kryer lëvizjen e tyre. Sa i takon tualeteve për personat me aftësi të kufizuara, vihet re se në shumicën e institucioneve nuk ka të tilla. Në Dhomën Civile të Gjykatës së Shkallës së Parë, nuk ka tualete për publikun dhe ato përdoren vetëm nga ana e stafit të Gjykatës. Institucionet që ofrojnë tualete të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara janë GJKKO, Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë dhe SPAK, të ndërtuara rishtazi.

d. Shkrimet e përshtatshme braille në institucione

Nga të gjitha institucionet pohohet se në hyrje të tyre tabelat orientuese janë në një shkrim relativisht të madh, i cili është i përshtatshëm për personat me shikim të pjesshëm. Për personat me kufizim të plotë në shikim pjesa më e madhe e institucioneve pohon se nuk ka shkrime orientuese në gjuhën braille. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë është përgjigjur se: “*është ndërtuar rruga e jashtme për PAK në shkrim, duke vendosur tri lloje pllakash betoni: me relief dhe me ngjyrë – shirita orientues; me ngjyrë dhe relief gunga -gunga për tregues rreziku; me ngjyrë dhe relief shirita me kthim 90 gradë.*

Bazuar në sa më sipër, KShH vlerëson se aksesin e personave me aftësi të kufizuara në institucionet e drejtësisë duhet të shikohet si një ndër nevojat parësore, në rikonstruksionin e ndërtesave të vjetra ku janë vendosur disa nga institucionet e drejtësisë. Në rast të ndërtimeve të reja për institucionet e drejtësisë dhe jo vetëm, KShH sugjeron parashikimit buxhetor të përshtatshëm dhe marrjen e masave për të garantuar aksesin më të thjeshtë të personave me aftësi të kufizuar.

2. Aksesit në drejtësi si rrjedhojë e efektive të zbatimit në praktikë të hartës së re gjyqësore

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH-së, bazuar në një petition të banorëve të rrethit të Matit²⁹, drejtuar KShH-së realizuan një misioni monitorimi në terren për të verifikuar ankesën në fjalë, specifikisht për të vëzhguar dëmet e referuara prej banorëve që janë krijuar nga zbatimi i hartës së re gjyqësore. Këto dëme referohen se kanë ardhur si rrjedhojë e shkrirjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Burrel, e vendosur në qendren e rrethit të Matit. Kompetencat territoriale të kësaj gjykate janë transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, pranë së cilës, banorët pretendojnë se ndeshen me pengesa në drejtim të aksesit në drejtësi, të tilla si mungesa e transportit publik, mungesa e infrastrukturës rrugore, si rrjedhojë distancat e largëta të njësive administrative të këtyre Bashkive nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, kostot tepër të larta e të papërbalueshme të transportit privat.

Nga verifikimet në terren, mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH-së vërejtën këto problematika:

- a) Mungesa e linjave të transportit publik për mbulimin e të gjithë zonës, nga fshatrat dhe njësitë administrative në drejtim të qendrës së qytetit të Burrelit dhe anasjelltas. Në qytetin e Burrelit ishin vendosur disa mjete të tipit “furgon” të siguruara nga vetë banorët për nxënësit e shkollave si e vetmja mundësi për të lëvizur nga qyteti në njësitë administrative përkatëse, duke sjellë kështu edhe “mbipopullimin” përtej kapaciteteve mbajtëse të mjetit.
- b) Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme dhe distancat jo-realiste - Banorët kanë referuar me shqetësim që një pjesë e mirë e njësive administrative dhe fshatrave nuk kanë një infrastrukturë të përshtatshme rrugore dhe se në rast të kushteve atmosferike të përkeqësuar, rruga bëhet shpesh herë e pakalueshme. Për të verifikuar distancat reale, pasi propozuesit e hartës së re gjyqësore ishin mbështetur në distanca të llogaritura në mënyrë satelitore me Google Maps, Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut të KShH përshkuan me makinë një nga itineraret rrugore të banorëve të zonave më të thella të Matit me destinacion përfundimtar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër³⁰. Me shqetësim vihet re se distanca normale, në kushte atmosferike të përshtatshme nga qendra e njësisë administrative më të largët të Bashkisë Burrel në drejtim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është 3 orë e 20 minuta dhe jo 2 orë e 23 minuta sikundër referohet nga propozuesit e hartës gjyqësore.
- c) Kostot e larta të transportit. Kostot e udhëtimit për të paguar taksinë për itinerarin nga Burreli dhe Njësitë Administrative të Rrethit Mat, drejt Qytetit të Dibrës arrijnë të paktën

²⁹ Koncept i përdorur në ndarjen e vjetër territoriale. Rrethi i Matit përbëhet nga 2 bashki dhe 10 komuna që janë Bashkia Mat (Bashkia Burrel), Bashkia Klos, Komuna Baz, Komuna Derjan, Komuna Gurrë, Komuna Koms, Komuna Lis, Komuna Macukull, Komuna Rukaj, Komuna Suç, Komuna Ulëz, Komuna Xibër.

³⁰ Njësia Administrative Macukull (njësi e largët e zonës së Matit, Bashkia Burrel) deri fillimisht në Qendër e qytetit të Burrelit dhe më tej për të udhëtuar drejt Bashkisë së Dibrës, pranë Gjykatës që ka kompetencën territoriale për këta banorë

vlerën 1600 lekë të reja për të paguar. Detyrimi për të përdorur taksi, lindte nga nevoja pasi linjat e transportit privat nuk të favorizojnë kthimin brenda ditës në shtëpi. Në rast se qytetarët do të zgjidhnin alternativën e udhëtimit me fugon, iu duhet të paguaje qëndrimin për një natë në qytetin e Dibrës ose të Burrelit (kur vijnë nga fshatrat e largëta) dhe kjo është akoma më e kostueshme.

- d) Si rrjedhojë e kostos dhe largësive, banorët u shprehën të demotivuar për ta ndjekur çështjen në rrugë gjyqësore, e për pasojë pohuan rruga më e shpejtë e shuarjes së konfliktit i çon ato drejt “vetëgjyqësisë” ose përndryshe konflikti do të mbetet i pazgjidhur. Ekzistenca më herët e gjykatës së Burrelit, krijonte në vlerësimin e banorëve siguri për rendin publik. E kundërta, krijon perceptimin për mosndëshkimin e akteve të paligjshme apo edhe krimeve që ndodhin në këtë zonë. Gjithashtu, shkrimi i kësaj gjykate do sjellë në vlerësimin e tyre edhe shpopullimin e zonave të cilat nuk kanë akses të drejtëpërdrejtë në shërbimet e domosdoshme.

VI. BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI

Informacion i përgjithshëm për të anketuarit

Në anketim u përfshinë 630 individë nga të cilët 71.6% i përkasin gjinisë femërore dhe 27.9% gjinisë mashkullore, ndjekur nga një pakicë prej 0.5% që zgjedhën alternativën “tjetër” për gjininë.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve





Figura 2. Përfaqësimi i anketuarve sipas moshës



Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 35-45 vjeç (27.7%); 26-35 vjeç (24.8%) dhe 18-25 vjeç (20.2%) të cilat përbëjnë pothuajse 72.7% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë kategorinë më pak të përfaqësuar në anketim me vetëm 3.5% të individëve të anketuar.

Sa i takon nivelin arsimor të të anketuarve, vërehet se shumica ose 41% e tyre janë me arsim të lartë ndjekur nga 27.6% që kanë nivel arsimor të mesëm të lartë. Kategoritë më pak të përfaqësuara në anketë mbeten të anketuarit pa asnjë nivel arsimor (0.6%) dhe ata me arsim fillor (0.6%).

Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas nivelit arsimor





Figura 4. Përfaqësimi i punësimit të anketuarve

Pjesa më e madhe e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat (36.8%) ndjekur nga një pjesëmarrje pothuajse e barabartë midis të punësuarve në një institucion shtetëror (21%) dhe të vetëpunësuarve 18.1% dhe të papunëve (15.6%). Studentët përbëjnë një përqindje minimale të të anketuarve, vetëm 6.4%.

Qarku Tiranë përmban përqindjen më të lartë të të anketuarve (22.8%) ndjekur nga qarqet më të mëdha në vend Durrës (15%), Elbasan (14%), Shkodër (14%). Pjesa më e vogël e të anketuarve është e përqendruar në Lezhë (2 të anketuar).




Figura 6. Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut

Gjetjet Kryesore: Barazia dhe mosdiskriminimi

Grupet me të prekura nga mungesa e barazisë apo diskriminimi vijnë të mbeten ndër të tjerë fëmijët, gratë, komuniteti LGTBIQ+, minoritetet, të moshuarit, njerëzit me të ardhura të ulëta që janë në vështirësi ekonomike si rrjedhojë e papunësisë ose për shkaqe të ndryshme sociale, etj. Kjo pjesë e sondazhit ka si qëllim të identifikojë perceptimet e grupeve të shoqërisë sa i takon

barazisë dhe mosdiskriminimit dhe bazohet në disa standarte hulumtuese të cilat janë ndërtuar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Shqipëri³¹.

KShH fillimisht synoi të identifikonte nëse të anketuarit i përkasin një grupi të marginalizuar apo jo. Pjesa më e madhe, 75.2%, e të anketuarve, mohuan se i përkisnin një grupi të tillë kundrejt 24.8% të cilët pranuan se identifikohen si pjesë e një grupi të marginalizuar. Të anketuarit u pyetën nëse ishte e paligjshme të diskriminosh dikë në vendin e punës për shkak të gjinisë, racës, fesë, orientimit seksual apo identitetit gjinor, bindjeve politike, etj. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 86% e tyre, pohojnë se diskriminimi me bazë të tillë është i paligjshëm, ndjekur nga 8% e tyre që pohuan se nuk dinin t'i përgjigjeshin pyetjen, ndërkohë që një pakicë prej 6% e të anketuarve nuk

e konsiderojnë të paligjshëm diskriminimin e dikujt për këto shkaqe.





Figura 8. A është e paligjshme të diskriminosh dikë në vendin e punës për shkak të gjinisë, racës, fesë, etj.?

Figura 9. A jeni ndjerë ndonjëherë i bullizuar/tallur në ambientin e punës?




Të anketuarit gjithashtu u pyetën nëse ishin ndjerë ndonjëherë të bullizuar në ambientin e punës. Rezulton se rreth 1 në 4 persona kanë përjetuar bullizëm në vendin e punës, kundrejt shumicës së të anketuarve, 80.5% e tyre të cilët mohojnë të kenë përjetuar bullizmin.

KShH pyeti kategorinë prej 20% të të anketuarve të cilët pohuan se janë bullizuar në vendin e punës të shpjegojnë rastet ku janë ndjerë të bullizuar. Të anketuarit kanë ndarë disa shembuj ku perceptojnë tendencën e drejtuesve apo eprorëve për të bullizuar vartësit. Ndër rastet më të zakonshme janë përdorimi i etiketimeve raciste (jevgë, egjiptiane etj), etiketimeve për shkak të origjinës (malok, fshatar, etj), etiketimet gjinore (drejtuar vajzave dhe grave) . Arsye të tjera për

³¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: neni 18 i Kushtetutës; Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

bullizimin në vendin e punës të shprehura më rrallë referohen të jenë: gjendja financiare, ndryshimi i gjinisë, invaliditeti, moshë.


Figura 10. A jeni ngacmuar ndonjëherë seksualisht nga dikush në ambientin e punës?



11% e të anketuarve kanë pohuar se janë ngacmuar seksualisht në punë, ndërkohë që 89% e tyre mohojnë situata të tilla. Nga të dhënat rezulton se shumica e të anketuarve që pohuan se janë ngacmuar seksualisht, ishin vajza ose gra. Ato kanë shpjeguar gjithashtu disa prej rasteve kur janë ndjerë të ngacmuar seksualisht nga veprimet e kolegëve apo fjalët e tyre. Në një rast të shpjeguar vihet re edhe vështirësia që kanë qytetarët për të identifikuar ngacmimet seksuale në punë, ku një prej të anketuarve pohon se *‘nuk e kam të qartë nëse jam ngacmuar apo jo, por në këndvështrimin tim kanë qënë prekje më shumë se mund të lejojë statusi i kolegut’*.

statusi i kolegut’.

Figura 10.1. Nëse ndodh kjo situatë në vendin e punës (ngacmimi seksual), ku duhet të raportohet?



Të dhënat reflektojnë përgjigjet e nën kategorizuara të pjesës së anketuesve që pohojnë se janë ngacmuar seksualisht (11% e totalit). Përkatësisht, 45,1% e të anketuarve pohojnë saktësisht se raste të tilla duhet të raportohen në strukturat e policisë, ndjekur nga 19,2% e të anketuarve që referojnë vetë punëdhënësit, 14,4% referojnë se nuk e dinë, 8,8% referojnë Inspektoratin e Punës, 5,7% kanë zgjedhur Avokatin e Popullit dhe 4,8% kanë zgjedhur asnjë prej alternativave.

Figura 11. Në rast se keni qenë viktimë e ngacmimit seksual në vendin e punës, a e keni raportuar këtë abuzim?

Shqetësues është fakti se vetëm një pjesë shumë e vogël e të anketuarve që kanë pohuar se kanë qenë viktimë e abuzimit seksual në vendin e punës kanë pohuar se i kanë raportuar ato (7% e tyre), kundrejt 93% të të anketuarve të cilët nuk kanë raportuar. Vihet re se të anketuarit të cilët kanë raportuar të tilla ngacmime, i kanë raportuar ato kryesisht pranë punëdhënësit, eprorit, strukturave apo punonjësve të burimeve njerëzore apo edhe familjes.






Figura 12. Sa herë keni qenë në një intervistë pune prej Janarit të vitit 2022?



36.5% e të anketuarve kanë pohuar se kanë marrë pjesë në një intervistë pune mbi një herë, kundrejt 56% të anketuarve të cilët nuk kanë patur asnjë intervistë pune së fundmi. Kontradiktore është e dhëna e


referuar nga 10.4% e të anketuarve që pohojnë se nuk e mbajnë mend sa herë kanë qenë në intervistë pune.

Figura 13. Nëse keni qenë në një intervistë për punë, a ju janë bërë ndonjëherë pyetje diskriminuese (mund të përzgjidhet më shumë se një alternative nga shkaqet e përmendura)?




63,1% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë patur pyetje me elementë diskriminues. 13,1 e të anketuarve janë përballur me pyetje diskriminuese për bindje politike, ndjekur nga 10,2% që referojnë pyetje për statusin martesor, 5,5% me pyetje të përkatësinë etnike dhe në të njëjtën masë edhe për besimin fetar (5,5%).

Figura 14. Në dijeninë tuaj, cilët favorizohen për t'u punësuar në një vend pune (në përgjithësi)?



1 në 3 të anketuar pohojnë se favorizimet në punë janë kryesisht për burrat, kundrejt rreth 28% të të anketuarve të cilët shprehen se nuk ekzistojnë favorizime të bazuara në identitetin gjinor. 1 në 4 të anketuar ose afro 21% e tyre pohojnë se gratë janë më të favorizuara.

Figura 15. A besoni se punëdhënësi ju ka dhënë ju dhe punonjësve të tjerë mundësi të barabarta për t'u ngritur në detyrë?



Vetëm 19,5% e të anketuarve ju përgjigjën pozitivisht pyetjes, ndërsa 20,5% e tyre pohojnë se kjo varet nga punëdhënësi i tyre. 29,7% mohojnë mundësitë e barabarta në promovimin në punë, ndërkohë që 30,3% janë përgjigjur se nuk e dinë.

Nga të anketuarit rreth 22,5% pohojnë se kjo ka ndodhur për shkak të orientimit seksual, ndjekur nga gjinia (6,3%) dhe pamja (6,7%), etj.

Figura 16. A ju ka ndodhur të mos konsideroheni për ngritje në detyrë për një nga arsyet e mëposhtme?




Figura 18. Nëse jeni grua, a keni qenë ndonjëherë shtatzënë në kohën që keni qenë e punësuar?

Rreth 1 në 3 të anketuarave (33% gra apo vajza) kanë pohuar se kanë qenë shtatzanë kur kanë qenë të punësuar ose janë aktualisht shtatzanë (5%).





Figura 19. A jeni detyruar të punoni 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes (nëse kanë qenë shtatzënë gjatë marrëdhënies së punës)?



punuar gjatë kësaj periudhe, jo konform legjislacionit shqiptar. Ndërkohë që 46.8% ka zgjedhur alternativën e paaplikueshme, e cila statistikisht krijon kontradiktë me të dhënat e referuara në përgjigjen e mëparshme.

Nisur nga parashikimet e Kodit të Punës për të drejtat lidhur me lejen e lindjes, KShH pyeti të anketuarit nëse janë detyruar të punojnë 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes. Rezultoi se një pjesë të konsiderueshme e të anketuarve (42.2%) nuk janë detyruar të punojnë gjatë kësaj kohe, por gjithsesi 11% të tjera kanë

Figura 20. A ju ka ndodhur ndonjëherë të mos paguheni, apo të mos merrni përfitime shtetërore gjatë lejes së lindjes?

54% e të anketuarave që kanë qenë shtatzënë gjatë marrëdhënies së punësimit e pohuan se kanë marrë të gjitha përfitimet e caktuara gjatë lejes së lindjes, kundrejt vetëm 7% të tyre të cilat pohuan të kundërtën.





Figura 21. A jeni kthyer në vendin e mëparshëm të punës pas pushimit më të fundit të lejes së lindjes?

Në 33% të rasteve, gratë janë kthyer në vendin e mëparshëm të punës konform detyrimeve të legjislacionit në fuqi, kundrejt 24% prej tyre të cilat pohuan të kundërtën.

Figura 21.1. Nëse përgjigjia e pyetjes së mësipërme është jo, përse nuk jeni kthyer në punë?

Disa prej arsyeve kryesore të përmendura të cilat i kanë detyruar gratë të mos kthehen në punën e mëparshme përfshijnë: mungesa e kujdesit për fëmijët dhe shërbimet e kujdesit ndaj fëmijës shumë të shtrenjta (23.5%), nisja e një pune të re (23.5%), mungesa e dëshirës për të vijuar punën (20.4%). Rreth 15.3% e të anektuarave pohojnë se nuk janë kthyer në punë për shkak se punëdhënësit ndërprejnë ose përfunduan kontratën e punës.





Figura 22. A ju ka ushtruar presion ndonjë punëdhënës që të ktheheni në punë më herët nga sa kishit planifikuar kohëzgjatjen e lejes së lindjes?




Duke përjashtuar 40% të të anketuarve për të cilët leja e lindjes është e paaplikueshme, 49% prej tyre pohojnë se nuk kanë patur presion nga punëdhënësi. Vetëm 11% e të anketuarve pohojnë se kanë ndjerë presion.

Figura 23. Kur u kthyet në punë (nga leja e lindjes) a kishit të njëjtat përgjegjësi?

Pjesa më e madhe e të anketuarve (40% e atyre që pranojnë se janë kthyer nga leja e lindjes në punë) pohojnë se kanë patur të njëjtat përgjegjësi kur janë kthyer dhe vetëm 6% e tyre pohojnë se kanë patur më pak përgjegjësi nga punëdhënësi.




Figura 23.1 Kur u kthyet në punë a kishit të njëjtat orë pune?




Pak a shumë i njëjti trend përgjigjesh vihet re edhe në figurën përbri (23.1), sa i takon orarit të punës pas kthimit nga leja e lindjes, ku 37.4% pohojnë se kanë patur të njëjtat orë pune, ndjekur nga 5.6% që pohojnë një trajtim më të favorshëm nga punëdhënësi, duke reduktuar numrin e orëve të punës.

Figura 24. Kur u kthyet në punë, a kishit të njëjtën pagë?



Shumica e të anketuarave që janë kthyer nga leja e lindjes pohojnë se kanë patur të njëjtën pagë (41% e tyre), ndjekur nga 3% që pohojnë një pagë më të ulët.

Figura 25. Gjatë kohës që keni qenë shtatzënë dhe derisa fëmija juaj ka mbushur moshën 1 vjeç, a keni kryer orë shtesë të punës me kërkesë të punëdhënësit?





Nga të dhënat rezultoi se vetëm 6% të të anketuarave kanë patur kërkesa për orë shtesë pune nga punëdhënësi gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që 40% e të anketuarave që janë rikthyer nga leja e lindjes, mohojnë oraret shtesë të punës, çka reflekton të njëjtin trend statistikor si në përgjigjet e pyetjeve të mëhershme.

VII. E DREJTA PËR UJË TË PASTËR E TË PIJSHËM


Informacion i përgjithshëm për të anketuarit

Në anketim u përfshinë 550 individë nga të cilët 54.7% i përkasin gjinisë femërore dhe 44.5% gjinisë mashkullore. Rreth 0.7% e të anketuarve zgjodhën të mos e japin këtë informacion.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve **Figura 2.** Përfaqësimi i të anketuarve sipas moshës



Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 18-25 vjeç (23%); 36-45 vjeç (21%), 26-35 vjeç (18.7%) dhe 46-55 vjeç (18.1%) duke përbërë kështu pothuajse 80.8% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë kategorinë më pak të përfaqësuar në anketim me 7.2%. Sa i takon nivelit arsimor të të anketuarve, vërehet një pjesëmarrje dominante e të diplomuarve me




arsim të lartë universitar dhe pasuniversitar me 44%, ndjekur nga 28% që kanë mbaruar gjimnazin. Pjesa tjetër e të anketuarve kanë arsim të mesëm të ulët (10%), 16% të anketuar me arsim profesional dhe 1% kanë arsim fillor.

Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas Nivelit arsimor

Figura 4. Përfaqësimi i punësimit të anketuarve

Vërehet se shumica e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat (26,5%) ndjekur nga të punësuarit në institucione shtetërore (22,4%). Të vetëpunësuarit përbëjnë 24,5 % të të anketuarve kundrejt personave të cilët janë të papunë që përfaqësohen në masën 17,2% të të anketuarve. 1 në 10 të anketuar ishin studentë.



Qarku Tiranë përmban përqindjen më të lartë të të anketuarve (28%) ndjekur nga qarku Shkodër (16%) dhe qarku Elbasan (13%). Pjesa më e vogël e të anketuarve është e përqendruar në Lezhë përfaqësuar nga vetëm 0.1% e të anketuarve.





Figura 5 . Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut

Gjetjet Kryesore: E drejta për ujë të pastër e të pijshëm

Standartet hulumtuese për realizimin e kësaj pjese të sondazhit sa i takon të drejtës për ujë të pastër e të pijshëm u bazuan në legjislacionin tonë në fuqi³² dhe synuan të mbledhin të dhëna edhe për zonat rurale.

³² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: neni 59 i Kushtetutës. Ligji për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotur.

Figura 6. Furnizimin me ujë në banesën tuaj e keni nëpërmjet ujësjellësit apo nga burime të tjera ujore (puse, autobotë, etj.)?



Për 91% të të anketuarve, ujësjellësi u mundëson furnizimin me ujë në banesë ndjekur nga rreth 7% e të anketuarve të cilët pohuan se e sigurojnë ujin nëpërmjet burimeve të tjera siç mund të jenë puset, autobotët etj.

Figura 7. Nëse furnizimi me ujë në banesën tuaj bëhet nga burime të tjera, a keni informacion për cilësinë e ujit?

Për pjesën në pakicë të të anketuarve që zgjodhën si alternativë të pyetjes së mëhershme “burimet e tjera”, 39% e tyre pohojnë se kanë informacion për cilësinë e ujit, ndjekur nga 23% të cilët shprehen se nuk e dinë kundrejt 14% të tyre të cilët mohojnë të kenë informacion mbi cilësinë e ujit që furnizohet nga burime si autobotë apo puse.





Figura 8. Nëse keni informacion, a është cilësia e ujit e përshtatshme për t’u konsumuar për gatim?



KShH vëren se 40% e të anketuarve pohojnë se cilësia e ujit është e përshtatshme për t’u konsumuar për gatim, ndjekur nga 33% që pohuan se cilësia e ujit nuk është e përshtatshme, 25% prej tyre nuk janë të sigurtë dhe për 1% mungon furnizimi me ujë të pijshëm.

Figura 9. Nëse furnizimi me ujë në banesën tuaj bëhet nëpërmjet ujësjellësit, ky furnizim është i pandërprerë apo me orar?

48% e të anketuarve furnizohen me ujë në banesën e tyre në mënyrë të pandërprerë, ndjekur nga 42% të cilët pohojnë se furnizimi me ujë është me orar. Një pjesë e vogël e të anketuarve, 3%, gjithashtu pohojnë se u mungon furnizimi me ujë.




Figura 10. A e përdorni për të pirë ujin që merrni nga ujësjellësi?



Shqetësues është fakti se një masë e konsiderueshme prej 46% të të anketuarve pohuan se nuk e përdorin ujin që marrin nëpërmjet ujësjellësit për ta pirë, kundrejt 30% të tyre që pohuan se e konsumojnë si ujë të pijshëm, ndjekur nga 21% që e konsumojnë pjesërisht. ndërkohë që mbetet konstante përqindja e qytetarëve të cilët pohojnë mungesën e furnizimit me ujë (3%).

Figura 11. Nëse uji nëpërmjet ujësjellësit nuk është i pijshëm, cila është forma me anë të së cilës e siguronin ujin e pijshëm?

1 në 2 persona ose 50% e të anketuarve e blejnë ujin e pijshëm, ndjekur nga 19% të të anketuarve të cilët pohojnë se përdorin sistemet e pastrimit të ujit për ta bërë ujin që përdorin të pijshëm. 12% e të anketuarve bëjnë furnizimin me ujë të pijshëm nga burime natyrale që ndodhen në zona të caktuara ndërkohë që 1 në 10 persona pohon se janë të detyruar të përdorin ujin me të cilin furnizohen nga ujësjellësi edhe pse nuk është i pijshëm. E dhëna e fundit krijon kontradiktë nga pikëpamja statistikore me përgjigjet e dhëna në pyetjen e mëhershme, nga ku rezultoi se 51% e të anketuarve e konsumonin plotësisht apo pjesërisht ujin e ujësjellësit.





Figura 12. A janë të përballueshme tarifat e shërbimit të ujësjellësit, bazuar tek të ardhurat tuaja mujore?



Për pjesën më të madhe të të anketuarve (48% e tyre), tarifat e shërbimit të ujësjellësit janë të përballueshme, ndjekur nga 33% e tyre të cilët pohojnë se këto tarifa janë pjesërisht të përballueshme dhe 16% e tyre që i konsiderojnë ato të papërballueshme.

Figura 13. A keni informacion se ku duhet të drejtoheni në rast të ndërprerjes apo ndonjë defekti të furnizimit me ujë?

Niveli i informimit të qytetarëve për adresimin e problematikave është i mirë pasi 64% e tyre pohojnë se kanë informacion ku mund të drejtohen për ankesat e tyre ndjekur nga 22% të cilët kanë një informacion një pjesëshëm dhe 14% e tyre që pohojnë se nuk kanë informacion.





Figura 14. Në rast të ndërprerjes apo ndonjë defekti të furnizimit me ujë, a është përgjigjur në kohë shërbimi i ujësjellësit me qëllim realizimin e shërbimit të kërkuar dhe riparimin e defektit?



Pjesa më e madhe e të anketuarve ose 52% e tyre pohojnë se kanë marrë përgjigje në kohë për problematikat që kanë patur me furnizimin me ujë, ndjekur nga 14% e tyre që pohojnë se nuk kanë marrë përgjigje në kohë ndërkohë që 10% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë patur asnjëherë probleme të tilla.

Figura 15. A i përmbush të gjitha nevojat tuaja familjare sasia ditore e furnizimit me ujë që keni në banesën tuaj?

Për shumicën e të anketuarve (ose 58%), sasia ditore e furnizimit me ujë është e mjaftueshme, ndjekur nga 28% të cilët pohojnë se, në opinionin e tyre, sasia ditore përmbush nevojat e tyre familjare pjesërisht. Për 13% e të anketuarve kjo sasi nuk i përmbush të gjitha nevojat e tyre familjare.






Figura 16. A mendoni që furnizimi me ujë në njësinë tuaj administrative bëhet në mënyrë të drejtë dhe transparente?



Shumica e të anketuarve (43%) pohojnë se furnizimi me ujë në njësinë e tyre administrative është i drejtë dhe transparent ndjekur nga 38% që pohojnë se nuk kanë dijeni për pyetjen, dhe 18% e tyre që pohojnë se mund të ketë padrejtësi dhe mungesë transparence në furnizimin me ujë në njësinë administrative ku banojnë.

Figura 17. A ka përpjekje nga shërbimi i ujësjellësit për të menaxhuar burimet ujore në mënyrë ekonomike dhe për të shmangur humbjet në njësinë tuaj administrative?

Pothuajse 1 në 2 persona (49% e të anketuarve) nuk kanë informacion nëse ekzistojnë të tilla përpjekje nga shërbimi i ujësjellësit, ndjekur nga 36% e tyre të cilët pohojnë se përpjekje të tilla ka. Ndërkohë, 14% e tyre pohojnë se shërbimi i ujësjellësit nuk bën përpjekje të tilla.





VIII. E DREJTA PËR AKSES NË EDUKIM DHE ARSIM CILËSOR

Informacion i përgjithshëm për të anketuarit


Në anketim u përfshinë 531 individë nga të cilët 59.7% i përkasin gjinisë femërore dhe 40.1% gjinisë mashkullore. Rreth 0.2% e të anketuarve zgjodhën të mos e japin këtë informacion.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve **Figura 2.** Përfaqësimi i të anketuarve sipas moshës



Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 36-45 vjeç (27%); 46-55 vjeç (25%), 26-35 vjeç (15.7%) dhe 18-25 vjeç (15%), të cilët përbëjnë 82.7% të të anketuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë kategorinë më pak të përfaqësuar në anketim me 4.3% të përfaqësuar.


Figura 3. Përfaqësimi i të anketuarve sipas nivelit arsimor



Sa i takon nivelit arsimor të të anketuarve, vërehet se shumica (40.4%) janë me arsim të lartë universitar ose pasuniversitar, ndjekur nga 29.5% e tyre që kanë mbaruar gjimnazin, 14% me arsim të mesëm të ulët dhe 14.8% me arsim profesional.

Figura 4. Përfaqësimi i punësimit të anketuarve

Shumica e të anketuarve janë të punësuar në sektorin privat (25,4%) ndjekur nga të punësuarit në institucione shtetërore (25,8%). Të vetëpunësuarit përbëjnë 24% të të anketuarve kundrejt personave të cilët janë të papunë që përfaqësohen në masen 17,5% të kampionit të anketuar. 7,3% e të anketuarve përfaqësojnë studentët.



Qarku Tiranë vijon të reflektojë përqindjen më të lartë të të anketuarve (34,3%) ndjekur nga qarku Shkodër (13,4%), qarku Vlorë (10,4%), qarku Durrës (9,2%). Numri më i ulët i të anketuarve është e përqendruar në Lezhë përfaqësuar nga vetëm 1 i anketuar.





Figura 5. Përfaqësimi i të anketuarve sipas qarkut

2. Gjetjet Kryesore: E drejta për akses në edukim dhe arsim cilësor

Figura 6. A jeni prind i një fëmijë që është duke ndjekur shkollën në sistemin parauniversitar?



Shumica e të anketuarve (59%) janë prindër të një fëmije që është duke ndjekur shkollën në sistemin parauniversitar kundrejt 41% të tyre që pohuan se nuk janë.

Figura 7. A ka ndjekur fëmija juaj në mënyrë të rregullt arsimin e detyrueshëm (nëntë vjeçar)?

Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë pohuar gjithashtu se fëmija i tyre ka ndjekur (34%) ose është duke e ndjekur aktualisht në mënyrë të rregull arsimin e detyrueshëm (35%). 10% e të anketuarve ka pohuar se fëmija e tyre nuk ka ndjekur arsimin e detyrueshëm ndërsa 21% prej tyre deklaruan se nuk kanë fëmijë.





Figura 8. A ju lejojnë të ardhurat tuaja mujore familjare që të përmbushni të gjitha nevojat e fëmijës/fëmijëve tuaj për arsimim?

33% e të anketuarve pohuan se të ardhurat mujore i lejojnë ata që të përmbushin nevojat e fëmijëve të tyre për arsim, ndjekur nga 24% të cilët pohojnë se i përmbushin këto nevoja pjesërisht. Ndërkohë, 21% e të

anketuarve pohojnë se nuk mund t'i përmbushin nevojat e fëmijëve të tyre lidhur me arsimimin për shkak të të ardhurave të tyre mujore familjare.

Figura 9. A keni dijeni për bursat e shkollimit që ofrohen për kategoritë në nevojë?

Shumica e të anketuarve (53.8%) kanë dijeni sa i takon bursave të shkollimit, kundrejt 46.2% të të anketuarve të cilët shprehen se nuk kanë dijeni rreht bursave për kategoritë në nevojë.




Figura 10. A keni patur ndonjë vështirësi që ju ka detyruar të mos e çoni fëmijën/fëmijët tuaj në shkollë?

Shumica e të anketuarve (58% e tyre) pohojnë se nuk kanë patur ndonjë vështirësi që i ka detyruar të mos e çojnë fëmijën në shkollë. Në 10% të rasteve të anketuarit pohuan se nuk kanë patur mundësi ti çojnë fëmijët në shkollë për një periudhë të caktuar, ndjekur nga e njëjta përqindje që pohon se ka patur vështirësi që kanë sjellë si rrjedhojë mosdërgimin e fëmijëve në shkollë. Trendi mbetet i njëjtë për personat të cilët pohojnë se nuk kanë fëmijë të cilët përfaqësojnë 22% të të anketuarve.






Figura 11. Në vendbanimin tuaj, a është shkolla lehtësisht e arritshme nga fëmija/fëmijët tuaj?


Për pjesën më të madhe të të anketuarve, (81%) shkolla është e arritshme. Megjithatë, pothuajse 1 në 5 persona pohuan se shkolla nuk aksesohet lehtësisht nga fëmijët e tyre.

Figura 12. A keni patur vështirësi në regjistrimin e fëmijës në shkollën më të afërt që ndodhet pranë vendbanimit tuaj?




Në shumicën e rasteve, regjistrimi në shkollë nuk përbën problem apo vështirësi për të anketuarit (60%). Për 19% të tyre, regjistrimi i fëmijës në shkollën më të afërt me vendbanimin rezulton se ka qënë i vështirë (10%) ose pjesërisht i vështirë (9%) .

Figura 13. A keni patur shqetësime lidhur me frekuentimin e rregullt të shkollës nga fëmija juaj?



59% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë patur shqetësime, ndjekur nga rreth 18% e tyre që pohojnë të kundërtën (prej të cilëve 8% kanë patur pjesërisht shqetësime).


Figura 14. Nëse përgjigjia e pyetjes së mësipërme është po, cilat kanë qenë shkaqet e mosfrekuentimit të rregullt të shkollës?



Shkaqet kryesore që të anketuarit referojnë për mosfrekuentimin e rregullt të shkollës nga fëmijët e tyre janë nevojat ekonomike dhe familjare (60%), varësia nga lëndët narkotike apo substanca të tjera (4%) apo për shkak të ndikimeve të rrethit shoqëror (32%). Statistikisht të dhënat lidhur me këtë pyetje krijojnë përshtypjen që përgjigjet lidhur me të janë dhënë edhe nga prindër të cilët nuk kanë raportuar më herët se kanë patur probleme me frekuentimin e shkollës nga fëmijët e tyre. Por, këto përgjigje mund të reflektojnë më gjerë vështirësitë në frekuentim se sa frekuentimin (ndjekjen ose jo të shkollës) sipas pyetjes pararendëse.

Figura 15. A keni komunikim të rregullt me drejtorinë dhe mësuesit e shkollës lidhur me mbarëvajtjen e shkollimit të fëmijës tuaj?

Rreth gjysma e të anketuarve (ose 47%) pohojnë se kanë komunikim të rregullt me stafin e shkollës në lidhje me shkollimin e fëmijës së tyre, ndjekur nga 17% e tyre, për të cilët komunikimi është i pjesshëm dhe 12% e të anketuarve që pohuan se nuk e kanë këtë komunikim të rregullt. Gjithashtu, tendenca statistikore paraqitet e ngjashme me këto të dhëna sa i takon pyetjes nëse prindërit e



anketuar kanë gjetur mbështetje dhe mirëkuptim nga drejtoria dhe mësuesit e shkollës për ecurinë e shkollimit të fëmijëve të tyre, ku 50% e tyre janë shprehur po, 17% kanë gjetur mbështetje të pjesshme dhe 9% pohojnë se nuk e kanë patur këtë mbështetje.





Figura 16. A keni gjetur mbështetje dhe mirëkuptim nga drejtoria dhe mësuesit e shkollës lidhur me ecurinë e shkollimit të fëmijës tuaj?

Figura 17. A mendoni se në qytetin/fshatin ku jetoni, u jepet mundësia të gjithë fëmijëve për të ndjekur sistemin arsimor parauniversitar në mënyrë të barabartë?

51% e të anketuarve mendojnë se mundësitë për fëmijët për të ndjekur shkollën janë të barabarta, ndjekur nga 20% e të anketuarve të cilët mendojnë se mundësi të tilla janë pjesërisht të barabarta, ndërkohë që 13% e tyre mendojnë se këto mundësi nuk janë të barabarta.



MONITORIMI I AKSESIT NË EDUKIM – NXËNËSIT E FSHATIT “BROJË”

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut pranë KShH-së realizuan një mision verifikimi në terren me fokus në respektimin e së drejtës për akses në arsim të nxënësve të fshatit Brojë, që ndjekin arsimin fillor, 9-vjeçar dhe atë të mesëm në shkollën publike “Nikë Mernaçaj”, në fshatin Tamarë në Bashkinë e Malësisë së Madhe. Nxënësit ankohen se udhëtojnë çdo ditë rreth 30-40 minuta me automjet për të zhvilluar mësimin duke qënë se në fshatin e tyre nuk ka një shkollë. Gjatë monitorimit, rezultuan një sërë problematikash lidhur me aksesin në edukim të nxënësve të mitur të kësaj zone, si vijon:

- Shkolla Nikë Mernaçaj frekuentohet edhe nga nxënësit të cilët jetojnë në fshatrat përreth përfshirë fshatrat Tamarë, Brojë, Kozhnjë, Vermosh, Lepushë, Selcë, Vukël, Nikç dhe Grabom. Distanca e katër prej këtyre fshatrave me shkollën është mbi 2 km, çka përbën vështirësi për frekuentimin e shkollës nga nxënësit që jetojnë në këto fshatra.

- Distanca me shkollën ka sjellë si pasojë mungesat e nxënësve në orët mësimore, të cilat konsiderohen si të justifikuara nga stafi mësimor për shkak të mungesës së transportit publik.
- Mungesa e transportit bëhet edhe me e vështirë gjatë dimrit, kur kushtet atmosferike në këtë zonë janë të këqija. Banorët kanë tentuar të gjejnë alternativa të përkohshme për transportin e nxënësve, me mjete private që kanë transportuar mbi 10 nxënës.
- Kostot e transportit: Sipas VKM Nr. 682, datë 29.7.2015³³, prindërit e fëmijëve marrin një vlerë financiare rimbursimi e cila është e pamjaftueshme për mbulimin e transportit edhe në mënyrë private. Konkretisht, familjarët rimbursohen me një kuotë ditore prej 121 (njëqind e njëzet e një) lekë ndërkohë që mbulojnë me shpenzimet e tyre pjesën tjetër të vlerës që konsistonte në një shtesë prej 100 (njëqind) lekësh në ditë, të cilat shkonin për llogari të transportuesit privat. Duke patur në konsideratë kushtet e vështira ekonomike të tyre si papunësia apo mungesa e ndihmës ekonomike, kjo pagesë përbën një barrë për këto familje që duan të arsimojnë fëmijët e tyre.

Sa më sipër, KShH vlerëson se situata paraqitet tejet emergjente dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme të Ministrisë përgjegjëse për arsimin në drejtim të sigurimit të transportit publik për fëmijët në nëmryrë që ata të kenë mundësi për të ushtruar të drejtën e tyre për arsim.

IX. E DREJTA PËR JETË TË SIGURT DHE KUFIZIMI I LIGJSHËM I LIRISË

KShH monitoroi Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë Krujë me qëllim verifikimin e kushteve të jetesës së qytetarëve që vuajnë dënimin pranë këtij institucioni. Disa nga problematikat e evidentuara gjatë monitorimit janë:

Mbipopullimi

Nga të dhënat e ofruara nga institucioni, KShH vëren se në kohën e ndërtimit, IEVP Fushë Krujë kishte kapacitet akomodues prej 312 personash, ndërkohë me ndryshimet e bëra në organizimin e institucionit kapaciteti akomodues është 382 persona. Në kohën e monitorimit në institucion ishin akomoduar 362 persona në përputhje me kapacitetin e IEVP-së.

Organika e institucionit

³³ “ Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”

Në institucion ka disa vende vakante në administratën e institucionit, në stafin e sigurisë me uniformë si dhe në stafin mjekësor. Komandimi i 4 punonjësve me uniformë në burgun e Zaharisë ka shkaktuar gjithashtu edhe vakanca de facto për stafin e IEVP Fushë Krujë.

Puna në institucion

Në kohën e monitorimit janë 21 të dënuar të cilët punojnë në këtë institucion si: sanitarë, mirëmbajtës, berber, punëtor lavanderie, ndihmës kuzhinier dhe shpërndarës ushqimi. Pagesat për një pjesë të dënuarve kanë vonesa për shkak të hapjes së llogarive bankare dhe rinovimit të kartave të identitetit.

Aktivitetet në institucion

Institucioni organizon ndeshje futbolli çdo ditë dhe aktivitete me natyrë fetare 3 herë në javë. Në IEVP gjenden dhe ambiente të dedikuara në formën e klasave, pa asnjë lloj pajisje, çka vështireson zhvillimin e aktiviteteve sociale në to. Në institucion organizohen klasa të arsimit 9 vjeçar, si dhe 4 lloje kursesh: anglisht, italisht, udhërrëfim turistik si dhe kujdestari sociale.

Kërkesë ankesat e të burgosurve

KShH vëren se kërkesat apo ankesat e të dënuarve dhe paraburgosurve realizohen nëpërmjet një formulari dhe në varësi të tyre kalon për trajtim në sektorë të ndryshëm. KShH vëren me shqetësim se në regjistrat përkatës nuk shënohet nëse kërkesë/ankesat trajtohen dhe nëse është respektuar afati ligjor në përputhje me ligjin nr. 81/2020 dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Kuzhina

Ambientet e kuzhinës ishin të rregullta megjithatë, vërehet se pajisjet me të cilat gatuhet dhe servirej ushqimi si dhe infrastruktura ishin të vjetra.

Për sa i përket personave me gjendje shëndetësore të veçantë, nuk ka një menu të veçantë, duke mos u ofruar ushqim të përshtatshëm sipas kërkesave të tyre shëndetësore, në shkelje të Ligjit Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Bibloteka

KShH vëren se biblioteka ishte në një gjendje infrastrukturore jo shumë të mirë dhe e pajisur me botime të vjetra dhe jo periodike. Pasurimi i saj me libra, si dhe realizimi i një koncepti për të afruar shtetasit e dënuar me librin janë elementë të rëndësishëm për rehabilitimin e shtetasve të dënuar ose paraburgosur.

Ambientet fetare

Në një nga godinat e regjimit, ndodheshin edhe dy ambiente fetare që frekuentoheshin nga të dënuarit, një kishë dhe një xhami. Te dyja ambientet rezultonin të bollshme dhe përgjithësisht të pastra.

Ambientet e paraburgimit

Në ambientet ku gjendeshin të akomoduar shtetasit e paraburgosur ishin të ndarë në qeli me 5-6 shtetas. Kushtet infrastrukturore të dhomave të paraburgimit ishin relativisht të vështira, ambienti nuk ishte i mjaftueshem për 6 persona dhe në dhomë ndodhej një tavolinë me vetëm 2 karrige. Për shkak të mungesës së ujit të ngrohtë, të paraburgosurit ngrohnin ujin me anë të një rezistence, e cila mund t'i vinte në rrezik të lartë.

Uji i pijshëm

KShH vëren se uji në institucion nuk është i pijshëm dhe detyrohen që ta blejnë ndërkohë që për këtë problem IEVP pohoi se uji për këtë institution sigurohet nga një pus ku sipas analizave që zhvillon NJVKSH Krujë rezulton se uji i këtij pusi është i pijshëm. Nga ana e të paraburgosurve kishte ankesa në lidhje me kohën e ajrimit, si dhe mundësia për aktivitete të tjera sic janë përdorimi i kalcetos. Të paraburgosurit ankoreshin për prezencën e madhe të lagështisë, sidomos në tualetin e qelisë, dhe mos krijimin e kushteve të përshtashme për të gatuar brenda qelisë.